



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar i auditimit financiar të ushtruar në Bashkinë Shijak

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

TIRANË, tetor 2025

NR.	PËRMBAJTJA	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4-8
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
3.	Opinion i auditimit	7-8
II	HYRJA	8-14
1.	Objektivat dhe qëllimi	8-8
2.	Identifikimi i çështjes	8-9
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
4.	Përgjegjësitë e audituesve	9-9
5.	Kriteret e vlerësimit	10-11
6.	Standardet e auditimit	11-11
7.	Metodat e auditimit	11-11
8.	Dokumentimi i auditimit	12-13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13-13
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtiveve të auditimit	14-14
2.1	<i>Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm</i>	14-28
2.2	<i>Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.</i>	28-52
2.3	<i>Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm</i>	52-76
IV	REKOMANDIME	76-80

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit IPSAS Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SH.P.K	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Përshkrim mbi institucionin dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Shijak, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin e vitit 2024 të datës 19.03.2025, të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2025-2027, buxheti fillestar 2024, buxheti i rishikuar 2024 dhe realizimi i buxhetit 2024.

- Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak shpenzimet janë realizuar në masën 71%, ku nga vlera e planifikuar prej 759,159 mijë lekë, është realizuar vlera 220,843 mijë lekë, nga të cilat:

Shpenzime për investime në vlerën 114,530 mijë lekë; shpenzime operative në vlerën 86,641 mijë lekë; shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 19,672 mijë lekë.

-Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak të ardhurat janë realizuar në masën 75%, ku nga vlera e planifikuar prej 282,581 mijë lekë, është realizuar vlera 211,587 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Shijak krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, për periudhën e aktivitetit 01.01.2024-31.12.2024, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm.

-Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

-Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

-Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale

dhe që vlerësohen me nivel të lartë rrisht. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në rrisht dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve, Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

-Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Shijak, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për shpenzime dhe investime nuk janë realizuar për shkak të mos analizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, kryesisht për mosrealizim të të ardhurave.

- Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak shpenzimet janë realizuar në masën 71%, ku nga vlera e planifikuar prej 759,159 mijë lekë, është realizuar vlera 220,843 mijë lekë, nga të cilat: Shpenzime për investime në vlerën 114,530 mijë lekë; shpenzime operative në vlerën 86,641 mijë lekë; shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 19,672 mijë lekë.

-Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak të ardhurat janë realizuar në masën 75%, ku nga vlera e planifikuar prej 282,581 mijë lekë, është realizuar vlera 211,587 mijë lekë.

-Mos zbatimi i rekomandimit për kontabilizimin e Aseteve të Bashkisë Shijak për vitin 2023 dhe regjistrimin e tyre në ASHK, si dhe mos verifikimi fizik i disponueshmërisë në inventarizimet e fund vitit, ku janë:

-115 prona të paluajtshme shtetërore nuk janë pajisur me certifikatë pronësie.

-54 prona të transferuara nuk janë regjistruar në kontabilitet, të cilat paraqiten në sipërfaqe dhe jo në vlerë.

-Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar nuk është regjistruar në ASHK. Sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, ndryshuar me VKM 684 date 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje e kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish-komunave/Bashkive”, i janë kaluar në pronësi Bashkisë Shijak me sipërfaqe gjithsej 427,2 ha, nga këto: Pyje 380,69 ha, Kullotë 16,35 ha, Toka joproductive 30,16 ha (tokë me bimësi pyjore) etj.

- Nga auditimi u konstatuan anomali në hartimin e pasqyrave financiare në llogaritë si vijon: - Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 2 (dy) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata jo materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 804,209 lekë dhe shpenzime amortizimi në vlerën negative 120,632 lekë. Në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 3 (tre) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 5,844,693 lekë dhe shpenzime amortizimi me vlerë kontabël negative 292,234 lekë, regjistrime në kundërshtim me pikat nr. 2.1, 5,6, 29 dhe 30 të Udhëzimit nr. 8, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i llogarive së shpenzimeve, 6001 “Paga, personel i përhershëm”, 6010, “kontribute sigurime shoqërore”, 6011 “kontribute sigurime shëndetësore” si dhe deklarimet

në sistemin tatimor për pagat bruto dhe detyrimet tatimore, për periudhën dhjetor 2023 deri në nëntor 2024, u konstatua një diferencë në vlerën 3,206,913 lekë në zërin shpenzime paga dhe 1,250,516 lekë në zërin shpenzime për kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore.

Kjo diferencë mes shpenzimeve për paga e deklaruar në pasqyrat financiare dhe atyre të deklaruara në tatime, është pjesa e pagave dhe kontributeve të paguara nga Projekti i Bashkimit Europian me nr. Kontrate IPA/2022/433-142 dhe nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes nr. 323/2 datë 29.03.2024.

-Nga Bashkia Shijak mbulimi i shpenzimeve të pagave kryer nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), sipas marrëveshjes nr. 323/3 prot. datë 29.03.2024, nuk është pasqyruar në grandet e përfituara. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, punëdhënësit i disbursohet 20% e grandit sipas pikës 4 te kreut IV “Mbështetja e përfituesve” të VKM Nr. 535, datë 08.07.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e punëve publike në komunitet.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën nr. 47/a të Udhëzimit nr. 8, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar

-Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit përdorin program “Excel” për regjistrimet e veprimeve kontabël si dhe për mbajtjen e regjistrit të asetëve të njësisë vendore. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri, pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, mund të ndikojnë në pasaktësi të veprimeve e rrjedhimisht në rezultate jo të sakta. Kjo gjë rrit riskun e moskuadrimin të drejtë dhe të saktë, si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemin e gabimeve matematikore. Mungesa e një programi të specializuar për menaxhimin e të dhënave, përveç gabimit njerëzor, mbart riskun e humbjes së të dhënave të rëndësishme për shkak të mungesës së backup-it automatik, veprime këto në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, germa “dh”; neni 29, pika 1; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1; me pikat nr. 14 e 15, të nenit 3, si dhe neni nr. 11, i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; me pikat nr. 26-30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Kryetari i Bashkisë Shijak, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të theksuara midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për saktësimin e hartimit të tij, mbështetur në realizimet e mëparshme dhe mundësitë objektive të të ardhurave dhe shpenzimeve, për të vijuar me analiza periodike të veprimtarisë për realizimin e buxheteve, për të siguruar buxhete reale në shërbim të qytetarëve.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shijak, të marrë masa për klasifikimin e saktë të aktiveve, sistemin e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shijak, të marrë masa për regjistrimin e saktë të kostove të shpenzimeve për detyrimet për tatime e sigurime shoqërore e shëndetësore si dhe sisteminet përkatëse, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

-Kryetari i Bashkisë Shijak dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik për një menaxhim të sigurt dhe efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë, të marrë masa për kalimin në sisteme të avancuara dhe të integruara informatike, të cilët do të rrisin efikasitetin në menaxhim dhe kontrollin e brendshëm.

- Kryetari i Bashkisë Shijak, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë

masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimit e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

I.3. Opinioni i Auditimit

Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Shijak, për periudhën ushtrimore 01.01.2024 - 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto/fondet neto, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare, si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

*Sipas opinionit tonë, bazuar në evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Shijak, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitit 2024, të shprehura në bazën për opinion.*

Baza për opinionin e kualifikuar:

Nee kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti Bashkia Shijak, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme bazuar në opinionin tonë. Opinioni e modifikuar e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet mbi to, janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). U konstatuan:

-Anomali në hartimin e pasqyrave financiare në llogaritë si vijon: -Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*”, dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 2 (dy) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata jo materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 804,209 lekë dhe shpenzime amortizimi në vlerën negative 120,632 lekë. Në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 3 (tre) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 5,844,693 lekë dhe shpenzime amortizimi me vlerë kontabël negative 292,234 lekë, regjistrime në kundërshtim me pikat nr. 2.1, 5,6, 29 dhe 30 të Udhëzimit nr. 8, “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

-Nga Bashkia Shijak mbulimi i shpenzimeve të pagave që është kryer nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), sipas marrëveshjes me Nr. 323/3 prot., datë 29.03.2024, nuk është pasqyruar në grandet e përfituara. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, punëdhënësit i disbursohet 20% e grandit sipas pikës 4 të kreut IV “*Mbështetja e përfituesve*” të VKM Nr. 535, datë 08.07.2020 “*Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e punëve publike në komunitet*”.

Sa më sipër është në kundërshtim me parimet e kontabilitetit në sektorin publik” të udhëzimit Nr. 8 i ndryshuar, pika nr. 47, (a) “*Për grandet e përdorura për shpenzimet e paguara*”.

-Bashkia Shijak, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivitetit, shënimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e hyrjes në përdorim, etj.

-Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me inventarizimin e aktiveve në fund të vitit, u konstatua që Bashkia Shijak nuk ka kryer procesin e inventarizimit në përputhje udhëzimin përkatës.

-Bashkia Shijak nuk ka kryer verifikimin fizik të disponueshmërisë së aktiveve në inventarizimet e fund vitit, proces i rëndësishëm për vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së aktiveve materiale të pasqyrave financiare.

-Bashkia Shijak nuk ka zbatuar rekomandimin për kontabilizimin e Aseteve të Bashkisë Shijak për vitin 2023 dhe regjistrimin e tyre në ASHK, i pronave si vijon:

-115 prona të paluajtshme shtetërore nuk janë pajisur me certifikatë pronësie.

-54 prona të transferuara nuk janë regjistruar në kontabilitet, të cilat paraqiten në sipërfaqe dhe jo në vlerë.

-Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar nuk është regjistruar në ASHK, sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, ndryshuar me VKM 684 date 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje e kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e Ish-komunave/Bashkive”, i janë kaluar në pronësi Bashkisë Shijak me sipërfaqe gjithsej 427,2 ha, nga këto: Pyje 380,69 ha, Kullotë 16,35 ha, Toka joproduktive 30,16 ha (tokë me bimësi pyjore) etj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 628/1 prot., datë 30.05.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Shijak”, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 05.06.2024 deri në datën 07.07.2024, në subjektin Bashkia Shijak për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 - 31.12.2024, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

B. Sh., Përgjegjës Grupi

E. Ç. Anëtar

A. R., Anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objekti dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Shijak.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që

auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti përfundimtar i auditimit, synon të identifikojë përbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Shijak, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do të përdoren për procedura auditimi që janë më të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Shijak.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Kryetari i Bashkisë Shijak (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Shijak, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Shijak në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të

auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Shijak është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne, vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm:* Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrisë së Financave, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar. Urdhër nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “*Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Shijak dhe Njësive Administrative*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;

- *Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të Pasqyrave Financiare:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar; Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”; Ligji nr.139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, i përmirësuar; Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Shijak.

- *Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:* Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;

Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- *Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave*: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- *Në fushën e administrimit e pronës publike*: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të bashkive”.

6. Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”, si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, etj.. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

7. Metodatat e auditimit: Në auditim është përdorur metoda mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

- *Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

-*Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

-*Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre

-*Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

-*Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korigjime të shumta të shifrave etj.

-*Verifikimi i transaksioneve*. Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

-*Intervistimi*. Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

-*Raporte dhe informacione*. Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

-*Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*. Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reklektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt konstatimeve, dhe projekt raportit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

-Zona Gjeografike: Bashkia e re Shijak kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 27,861 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 48,554 banorë. Bashkia e Shijakut ka një sipërfaqe prej 92.19 km².

Të dhëna të tjera

Historik i zhvillimit ekonomik: Bashkia e re Shijak shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen. Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fashone dhe ajo përpunuese e prodhuese. Në territorin e Bashkisë Shijak ushtrojnë aktivitetet 955 biznese, nga këto: - 653 subjekte biznesi i vogël, - 302 subjekte biznesi i madh.

Bashkia Shijak ka 15 shkolla, si: 2 gjimnaze dhe 13 shkolla 9-vjecare (17 kopshte e çerdhe). Shijaku është një zonë që ka pasur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni.

Rritja e popullsisë si dhe emigrimi kanë sjellë shumë ndërtime të reja përgjatë 25 viteve të fundit të cilat janë ndërtuar pa një plan të mirëfilltë zhvillimor. Bujqësia është orientuar drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar si kultivimi i perimeve dhe foragjereve, mbarështimi i bagëtive dhe pemëtarisë.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a. njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

a) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

b) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

c) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

ç) realizimit të shërbimeve në formë të përshatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

d) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

dh) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm

Në zbatim të pikës 1. të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar me Nr. 428 Prot. më datë 24.10.2024;

2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës me Nr. 468 Prot. më datë 07.11.2023;

3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi me Nr. 1066 Prot. me urdhër Nr. 105 Prot. më datë 06. 03. 2024 dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë Nr. 4093 Prot. me urdhër, Nr. 399 më datë 01. 10. 2024, emërimet e punonjësve dhe personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në bashkinë Shijak a është reflektuar edhe në rregullore;

4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar Nr. 3893 Prot. urdhër nr. 370 më datë 19.09.2024;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik Nr. 638 Prot. me urdhër NR. 64 më datë 08.02.2024;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnim të tyre Nr. 131 Prot. me urdhër Nr. 16 më datë 10.01.2024 si dhe realizimin e trajnimeve të kryera për vitin 2024 të Bashkisë Shijak, Nr. 3950/1 Prot. më datë 04.11.2024.
7. Strategjinë, Plan-Pune Prot 432/4 më datë 26.01.2024 dhe Regjistrin e Riskut Nr. 432 Prot. më datë 26.02.2024 si dhe Nr. 911/2 më datë 28.02.2024;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe është dërguar në Ministrinë e Financave Nr. 911 Prot. më datë 28.02.2024.
11. Ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 Nr. 639 Prot. me urdhër Nr. 65., më datë 08.02.2024.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Shijak, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8. 7. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”.

- Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:
 - ✓ *Në lidhje me parimin 1* “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.
 - Mjedisi i kontrollit është pjesë esenciale e menaxhimit financiar dhe atij të kontrollit, i cili garanton vendosjen e objektivave të nevojshme të cilat çojnë në realizimin e misionit të institucionit që është integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe e punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe performanca në punë; Struktura organizative, garantimi në ndarjen e detyrave, hierarkia dhe rregullat e përcaktuara qartë, të drejtat, kompetencat dhe linjat e raportimit; Mënyra për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe profesionalizmi i punonjësve në tërësi.

- Struktura organizative, garantimi në ndarjen e detyrave, hierarkia dhe rregullat e përcaktuara qartë, të drejtat, kompetencat dhe linjat e raportimit.
- Është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Shijak me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Urdhër nr. 428 prot., datë 24. 10. 2024 rregullorja e brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shijak dhe Njësive Administrative” pjesë e të cilës është dhe Kodi i Etikës. Mënyra sipas së cilës stafi njihet me rregulloren si dhe bazën ligjore në fuqi, zhvillohet në formë individuale, dhe jo në bazë të trajnimeve përjashtim (ASPA).
 - Në nenin 3 të kodit të etikës janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes përcaktohen në Kreun 2 neni 4. Ndërsa përsa i përket rasteve ku vihen re parregullsi, mashtrime, janë përcaktuar në nenin 14 dhe 44, të cilat nuk janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme por në Kodin e Etikës, duhet thënë që mungon një procedurë e saktë për sinjalizimin dhe evidentimin e tyre. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve që përbëjnë shkelje, ndiqen procedurat e masave disiplinore, të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.
 - Nga bashkia raportohet se nuk ka pasur raste të shkeljes së etikës.
- Përsa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi në njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15. 07. 2010, Kapitulli III, pika 3. 1.
- Ankesat që vijnë nga jashtë depozitohen zyrtarisht, pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënive me Publikun), duke i’u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problematikave, të cilat duhet të trajtohen, ndërsa kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga Drejtorët, sipas sektorit përkatës që ka shqyrtuar problematikën, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18. 09. 2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. E gjithë procedura është e përcaktuar në pikën 11. 2 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme.
- Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17. 10. 2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26. 02. 2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë”, vlerësimi i punonjësve, të cilët kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip njëherë në 6 muaj. Gjithashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune me këtë procedurë merren burimet njerëzore.
- Është dërguar Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për Bashkinë Shijak për vitin 2024, me shkresën nr. 956prot, datë 26. 02. 2025.
- Është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me shkresën nr. 669 prot., datë 11. 02. 2024 raportimi mbi komponentët të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) Bordi apo Këshilli i Drejtuesve duhet të sigurojnë mbikëqyrjen dhe monitorimin mbi aktivitetin e çdo drejtori/sektori dhe të çdo punonjësi, me integritet personal dhe etikë profesionale, duke përjashtuar çdo konflikt interesi në kryerjen e detyrave funksionale, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08. 07. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin”

Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

- Ka raporte periodike të monitorimit të planit të veprimit për KB, analizës së veprimtarisë të Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ata mbulojnë.

- Jo për të gjitha mbledhjet të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Për vitin 2024 ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, struktura përgjegjëse dhe lidhjen me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Nga njësitë e varësisë ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar periodikisht dhe janë paraqitur pranë këshillit bashkiak si dhe në MFE. Ka Raportime periodike vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm ose i jashtëm nëpërmjet veprimtarisë audituese. -Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

✓ ***Në lidhje me parimin 3*** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Shijak me Vendimin e Kryetarit Urdhër nr. 428 prot. , datë 24. 10. 2024. -Organigrama e Bashkisë Shijak është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 3 nënkryetar dhe 6 drejtuesit e Drejtorive kryesore, 3 Administratorët e NJA e Titullarët e institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale. Nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori, llogaridhënia është në vijë vertikale.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialisti.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

Për vitin 2024 është miratuar struktura sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 1066 Prot. me urdhër nr. 105 më datë 06. 03. 2024 si dhe më pas i ndryshuar me nr. 4093Prot. me urdhër nr.

399 më datë 01. 10. 2024“Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shijak, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 29 datë 26. 08. 2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë për vitin 2024 të Bashkisë Shijak, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara” të ndryshuar, dhe të miratuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 489/3 Prot. datë 04/09/2024, gjithsej janë miratuar 356 pozicione pune. Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 4093/1 datë 11.10.2024 me urdhër të brendshëm nr. 408 më datë 11.10.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë i ndryshuar, të punonjësve administrativë për vitin 2024 të Bashkisë Shijak, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara” dhe të miratuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 489/3 më datë 04. 09. 2024 i ndryshuar janë shtuar deri më 11.10.2024 17 pozicione pune dhe numri total i punonjësve në Bashki të miratuar është 356 punonjës . Për 84 pozicione pune, rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. 15 pozicione pune, janë të zgjedhur dhe funksionarë kabineti. 86 pozicione pune funksione të deleguara. Si dhe 171 punonjës te cilët ndahen sipas kategorive polici bashkiake, IMTV, çerdhe, sporti, punonjës shërbimi.

- *Vakanca e pozicioneve të rëndësishme.*

- Në strukturën e Bashkisë nuk rezulton i emëruar Sekretari i Përgjithshëm, deri më 16. 02. 2024 i cili është nëpunësi civil më i lartë i administratës së bashkisë i cili është emëruar me vendimin nr. 40 më datë 16. 02. 2024 Nr. 5701/7 Prot. edhe pse në rregulloren e miratuar me Vendimin nr. 428, datë 24. 10. 2024 pozicioni dhe detyrat e këtij funksionari janë të përcaktuara qartë. Vakanca e këtij pozicioni duke parë dhe rëndësinë e detyrave funksionale që ai ka, rrezikon të krijojë probleme në zhvillimin e një veprimtarie normale të përditshme nga Titullari i Bashkisë.

-Mungon vendimmarrja nga titullari i bashkisë për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 12, pika (b) të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

- Nga sa më lart konstatohet se për vitin 2024, ka mangësi për pozicionet kryesore drejtuese si dhe ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës, në numrin e saj, çka në gjykimin e grupit të auditimit ndikon negativisht në performancën dhe realizimin e objektivave institucionale, duke mos pasur qëndrueshmëri në numrin e punonjësve, dhe duke krijuar kështu paqartësi si pasojë e ndryshimeve të shpeshta.

- Vërehet se deri më 31. 12. 2024,vakancat për pozicionet të kategorisë ekzekutive janë 5 dhe nga plani ne fakt kemi një diferencë prej 21 punonjësish.

-Bashkia Shijak ka faqen e saj zyrtare në Web në të cilën janë paraqitur të gjitha informacionet e njësive vendore si dhe dokumentet e rëndësishme.

-Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike si dhe raportimi në kohe i situacioneve.

✓ ***Në lidhje me parimin 4*** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Nëpunësit e Bashkisë Shijak i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist, me Ligjin nr. 152/2013, datë 17. 10. 2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrative dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyje, kullota, punonjës sporti etj.) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12. 07. 1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15. 07. 2010, ku përcaktohet:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
 - Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
 - Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
 - Një sistem për vlerësimin e performancës;
- Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar plani i rekrutimit të tyre. Nga informacioni i marrë nga grupi i auditimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se; rekrutimi i punonjësve është kryer në përputhje me ligjin e Shërbimit Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila përmban të dhënat mbi krijimin e marrëdhënies së punës, arsimimin, kualifikimin, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve në punë. Dokumente përkatëse që vërtetojnë gjendjen familjare, diploma e shkollës së lartë, lista e notave, certifikata për kualifikime të ndryshme, dëshmi e gjuhëve të huaja, etj.
- Mbahet një përshtatje detyrash individuale me bazë urdhrat e punës, por jo një sistem i cili do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.
- Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit. Programi vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit bëhet në bashkëpunim me ASPA (shkolla e administratës publike).
 - Për bashki nëpunësi autorizues(deri më 19. 09. 2024 sepse ne vijim me urdhër Nr. 370 datë 19. 09. 2024 është emëruar z. T. Xh. i deleguar për një pjese të kompetencave), është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.
 - Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.
- ✓ ***Në lidhje me parimin 5*** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.
- Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).
 - Çdo titullar i njësive publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësive. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësive.
- Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26. 06. 2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27. 04. 2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 10296 datë 08. 07. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30. 07. 2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 64 datë 08. 02. 2024 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjive Buxhetore dhe Integrimin”, Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr. 23, datë 30. 07. 2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i GMS është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e Bashkisë.

- Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se në Bashkinë Shijak nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”, vetëm urdhrin nr. 17 datë 11. 01. 2024 për PBA 2025-2027.
- Por mbahen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatori të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollit i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi ka pasur raste për delegimin e detyrave.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

✓ **Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund ti delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili i është deleguar drejtorit të financës.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vetëvendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni i ndarjes se risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Nga Bashkia Shijak përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Shijak nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Shijak, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

✓ **Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Në Bashkinë Shijak është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, por nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08. 07. 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku citohet se: "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut".

- Drejtorja e Burimeve Njerëzore nuk punon ende me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word- it.

- Në Bashkinë Shijak, po ashtu Drejtorja Ekonomike përmbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtorja e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

✓ ***Në lidhje me parimin 8:*** "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

- Bashkia Shijak nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

✓ ***Në lidhje me parimin 10:*** "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave

financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacione takt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj. , të vulosura nga dega e Thesarit dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Nuk ka gjurmë auditimi mbi aktivitetin e përputhshmërisë të njësisë të strukturave të prokurimit të cilat veprojnë në Bashkinë Shijak.

- Për planifikimin e territorit u konstatua mosrespektimi i kuadrit rregullator në fushën e dhënies të lejes së ndërtimit.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por vepohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve vepohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësura si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë të urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit në bashkinë Shijak. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Shijak, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Shijak të bërë me këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

-Bashkia Shijak në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresën nga Bashkia.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08. 07. 2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

✓ **Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Në Bashkinë Shijak nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.

-Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

-Në strukturën e Bashkisë Shijak janë 4 specialist IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria e Financës, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e list pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09. 08. 2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

✓ **Në lidhje me parimin 13:** “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdorin formacion cilësor”. Bashkia Shijak disponon faqen e saj zyrtare në web <https://www.shijak.gov.al/> ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë.

✓ **Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

✓ **Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin nr. 23 “Marrëdhëniet me publikun”.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme.

- Grupi auditues konstaton se nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të emailit zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

-Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

✓ **Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet çdo 4 muaj konkretisht, Nr. 2360/5prot vendim nr. 8 datë 31/05. 2024 si dhe NR. 1011/3 vendim nr 7 date 29. 02. 2024. . Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit **para faktit dhe pas faktit** në

lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia Shijak lidhur me pyetësin e vetë vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE, brenda afateve të përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 8. 7. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me shkresë Nr. 956Prot. datë 26. 02. 2025.

- Në Bashkinë Shijak mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Në Bashkinë Shijak aktivitetet e vlerësimit të njësive nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshëm dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

✓ ***Në lidhje me parimin 17:*** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Shijak në bazë të programit të auditimit nr. 628/1 Prot, datë 30.05.2025, “Mbi Auditimin Financiar” për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, në Bashkinë Shijak.

Në zbatim të pikës 1. të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës ***për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike***”, ***u auditua dokumentacioni si më poshtë:***

“Baza Ligjore”

-Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016,

VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, me VKM nr. 353/2016.

-Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”, brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”

Për vitin 2024 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr. 5384 dt. 20.11.2023 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2024-2026 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm.

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Shijak për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2024 me shkresën nr. 669 prot., datë 11.02.2025. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkinë Shijak për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike.

Karta e AB: Karta e Auditimit të Njësisë AB dhe Urdhri i Titullarit për miratimin e saj, është ngritur me Urdhrin e Titullarit nr136 nr. 3215/1 Prot. 21., datë 21.05.2021, “Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm” dhe Karta e Auditit të Brendshëm e dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me nr. 3215/2 prot date 21.05.2021. për sa me sipër u përmend, nga grupi auditimi vërehet një mangësi në rifreskimin e dokumentit i cili sipas **Manualit të Auditimit të Brendshëm**, Kapitulli II — **Standardi 1000**, neni 2. 1 faqe 8 thotë: Standardi 1000 – Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësitë Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohet formalisht në Statutin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës dhe Standardeve. Drejtuesi/ja i Auditimit të Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statusin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim te menaxhimi i lartë dhe bordi.

Me termin periodikisht duke u bazuar edhe tek Praktika profesionale ndërkombëtare (p. sh. , IIA) te cilat rekomandojnë një rishikim **periodik, së pari një herë në vit** për motiv që:

1. të ruhet **përputhshmëria me misionin dhe ndryshimet ligjore;**
2. të mbaj Kartën aktuale brenda kërkesave të menaxhmentit dhe komitetit auditues, sugjerohet rifreskimi i saj.

Plani Vjetor: Për vitin 2024 është miratuar me nr. prot 5384 data: 20.11.2023.

Për vitin 2024 janë planifikuar 9 auditime janë realizuar 2 auditime si më poshtë:

- Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore dhe Kadastra Fiskale
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
- Drejtoria Juridike Prokurimet Publike
- Sektori planifikimit kontrollit dhe zhvillimit të Territorit (sistemi e-lejeve) raport përfundimtar nr. 142/3prot. më 29.01.2025.
- Auditim i detyrave të lëna Janar Mars vitin ushtrimor
- Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
- Drejtoria Ekonomike Detyrimet e Prapambetura raport përfundimtar 3944/3 më 18.11.2024.
- Auditimi i detyrave të lëna
- Njësia Administrative Xhafzotaj, Nj. Adm Gjepalaj
- Nj. Adm Maminas.

Në tabelën e mëposhtme janë të shprehura në numër të dhënat sipas raportimit si më poshtë:
Tabela nr. AB Të dhënat sipas raportimit.

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT								
		Auditime ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit			Performace	Tematik	Teknologjisë së informacionit	Zbatim Rekomandime
				Perputh	Financ	Kombinuar				
1	Viti 2023	9	2	-	-	2	-	-	-	-

Burimi : Bashkia Shijak

Nga të dhënat sipas raportimit për vitin 2024 janë planifikuar të realizohen 9 auditime nga të cilet 2 të kombinuar janë realizuar.

Në tabelën e mëposhtme janë të shprehura në numër rekomandimet në bazë të auditimeve të kryera:

Tabela nr. AB3 Rekomandimet e shprehura në numër.

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT			
		Rekomandime te shprehura ne numër			
		Gjithsej numër	ne Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2024	8	-	8	-

Burimi : Bashkia Shijak

Nga 2 auditimet e kryera janë dhënë gjithsej 8 rekomandime, nga të cilat 8 janë në proces zbatimi.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7. 1. 1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Në disa dosje u vërejtën se nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3. 2 “Plani vjetor i Auditimit”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Disponohen planë veprimi të subjekteve të audituara me mungesa. Planet e veprimi nga NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve të kreut 4. 1. 13. 1 dhe 4. 1. 13. 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3, si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4; mos raportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të Kreut 4. 1. 13. 3 “Përgjegjësitë e njesisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit dhe të zbatohen, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, por kemi një mos përmbushje faktike të realizimit të planifikimit. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Mungon dhënia e opinionit në Projekt Raport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimeve për të gjithë auditimet e kryera sipas Standardi 2450 - Opinionet e Përgjithshme, në kundërshtim me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 i Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”. Nuk është realizuar plani auditimeve sipas numrit të miratuar. Gjithashtu konstatohet se, nuk mbahen elektronikisht dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar me qëllim për t’i shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6. 3.

Për sa i përket strukturës së AB u vëre se numri faktik i punonjësve, specialist është 1 dhe përgjegjës është 1. Në Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitet 2024-2026 që i është dërguar MFE Drejtorisë së Harmonizimit të AB me

nr5384 prot. më 20.11.2023, numri i planifikuar i strukturës për kryerjen e planit të auditimeve është 3.

Për sa më sipër duke theksuar dhe pikën 3 të Vendimit nr. 83, datë 03.02.2016, Miratimi i kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm ne sektorin publik, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 26 të ligjit nr. 114/2015, Për auditin e brendshëm ne sektorin publik, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave vendosi; “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.” Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik. Bashkangjitur vërejtur vonesën nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerzore në shpalljen e vakancës për pozicionin e specialistit, s i pasojë nga 9 auditime të planifikuara janë arritur të kryhen vetëm dy duke mos realizuar planin.

2.2 Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Në zbatim të pikës 2, nënpika 1,2,3,4 të programit të auditimit nr. **628/1 prot., datë 30/05/2025**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pasqyrat Financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024.

Ditarët e kontabilitetit për periudhën e vitit 2024.

Listë pagesat me zgjedhje për periudhën e vitit 2024.

Dokumentet e bankës dhe të arkës të vitin 2024.

Aktet e rakordimit me degën e thesarit Shijak, për vitin 2024.

Dokumentet e inventarizimit etj., të vitit 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit, pika 2. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë. Nënpikat:

3.1. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme“, etj.,

3.2. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.3. Vlerësimi i arsyeshmëri e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

3.4. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit përdorin program “Excel” për regjistrimet e veprimeve kontabël si dhe për mbajtjen e regjistrit të asetëve të njësisë vendore. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri, pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, mund të ndikojnë në pasaktësi të

veprimeve e rrjedhimisht në rezultate jo të sakta. Kjo gjë rrit riskun e moskuadrimit të drejtë dhe të saktë, si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e një programi të specializuar për menaxhimin e të dhënave, përveç gabimit njerëzor, mbart riskun e humbjes së të dhënave të rëndësishme për shkak të mungesës së backup-it automatik, veprime këto në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, germa “dh”; neni 29, pika 1; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1; me pikat nr. 14 e 15, të nenit 3, si dhe neni nr. 11, i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; me pikat nr. 26-30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Nënpika 2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në lidhje me auditimin mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024, në Bashkinë Shijak konstatohet se:

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Shijak, për vitin 2024, Formati nr.1, janë depozituar në Degën e Thesarit Shijak për vitin 2024, në datën 27.03.2025, sipas shkresës nr. 1442 prot datë 27/03/2025

Janë plotësuar bilancet për vitin 2024 dhe pasqyrat anekse të tyre, e konkretisht me përbërjen si vijon:

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; (formati 7/a, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), formati 7/b, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2024, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia publike Bashkia Shijak.

Periudha 2024 Formati nr.. 1 në lekë, Aneksi 2/1

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	4,275,802,688	4,072,514,227
2		I. Aktivët Afat shkurtra	736,199,840	502,531,022
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	499,201,952	270,412,853
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	496,222,552	267,169,453
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera	2,979,400	3,243,400
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	58,815,831	53,276,443
12	31	Materiale	8,619,926	7,187,509
13	32	Inventar I imet	50,195,905	46,088,934
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	178,182,057	178,705,077
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		

23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoha		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetstore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshem	151,105,340	158,876,381
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	27,076,717	19,828,696
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvlëresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	136,649
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	136,649
42		II.Aktivët Afat gjata	3,539,602,848	3,569,983,205
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	39,985,913	47,042,251
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	39,985,913	47,042,251
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	3,480,426,308	3,503,750,327
48	210	Toka, T,roje, Terene	25,654,385	25,654,385
49	211	Pyje, Plantacione	4,830,000	4,830,000
50	212	Ndertesë e Konstruksione	1,112,453,772	1,144,279,396
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,280,537,504	2,277,353,133
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	20,170,863	21,574,429
53	215	Mjete Transporti	23,731,126	24,980,132
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	13,048,658	5,078,852
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	242,600	242,600
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrije ne kapitalin e vet	242600	242,600
62		4.Investime	18,948,027	18,948,027
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	18,948,027	18,948,027
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	220,746,334	226,177,660
66		I.Pasivet Afat shkurtra	220,746,334	226,177,660
67		1. Llogari te Pagushme	220,746,334	226,177,660
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,355,754	1,247,755
69	42	Detyrime ndaj personelit	18,706,693	14,290,081
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,887,790	676,791
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	6,482,234	4,862,824
76	436	Sigurime Shendetstore		
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditorë per mjete ne ruajtje	39,584,878	44,092,535
82	467	Kreditorë te ndryshem	3,357,400	3,594,400
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	148,371,585	157,413,274
84	49	Shuma te parashikuara per xhvlëresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditorë, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		

94		Provizionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	4,055,056,354	3,846,336,567
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	4,055,056,354	3,846,336,567
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,147,535,908	2,195,342,576
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	456,637,674	223,076,918
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	1,450,882,772	1,427,917,073
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera		0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	4,275,802,688	4,072,514,227

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivit, si në vijim.

A. Aktivet.

Për vitin 2024.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”**, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitorë **496,222,552 lekë**.

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Shijak, kjo llogari **është për vlerën 496,263,261 lekë**.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2024
1	Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”	496,222,552
2	Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	39,584,878
3	Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”	456,637,674

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” në të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, është konstatuar një diferencë në fund të vitit ushtrimor në vlerë 40,709 lekë.

në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2024 paraqitet në vlerën 8,619,926 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë **32 “Inventar i imët”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2024 paraqitet në vlerën 50,195,905 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogari të arkëtueshme, -Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 158,876,381 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2024 paraqitet në vlerën 151,105,340 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna

nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2024. Në mënyrë analitike paraqitet në vijim:

Aneksi nr.2, pika për detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë Shijak vitin/*2024

Nr	Subjekti debitor Juridik dhe Fizik	Përshkrimi	Vlera në lekë	shtesa	pakesime	Mbetje në lekë
1	S. B.		24,521,525			24,521,525
2	F. K.	Klsh 2015	642,000			642,000
3	D. D.		50,000			50,000
4	T. E.		42,680			42,680
5	E.A.		48,920			48,920
6	C.		389,160			389,160
7	L. V.		251,568			251,568
8	M. B.		594,987			594,987
9	I.M.		74,004			74,004
10	E.		14,333			14,333
11	E.		13,720			13,720
12	E.		9,732			9,732
1	E.		30,401			30,401
14	B.	Klsh 2018	418,600			418,600
15	D. S.		31,570			31,570
16	M.D.		41,000			41,000
17	M. K.		41,000			41,000
18	E. M.		41,000			41,000
19	S.V.		50,000			50,000
21	S. Gj.		41,000			41,000
22	T. Sh.		50,000			50,000
23	V. V.		41,000			41,000
24	M. Sh.		100,000		65,000	35,000
25	A. V.			637,340	637,340	0
26	A. V.			628,038	628,038	0
27	E. A.	Klsh	309,349		309,349	0
28	E. A.	Klsh	303,160		303,160	0
29	A. A.	Klsh	368,190		368,190	0
30	C.	Klsh	276,320		276,320	0
31	C.	Klsh	606,900	722,000	606,900	722,000
32	R.			8,185,250		8,185,250
33	A. C, Xh. T.			3,100,936		3,100,936
34	Taksa Biznes		30,523,819	65,343,000	65,956,375	29,910,444
35	Taksa Popullsie		81,950,443	64,884,477	77,121,410	69,713,510
36	Licenca e Karburante.		17,000,000		5,000,000	12,000,000
	TOTALI		158,876,381	143,501,041	151,272,082	151,105,340

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Si përfundim konstatohet se:

*Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2024, paraqitet në vlerën **151,105,340** lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.

-Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (debitorë) më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 19,828,696 lekë, më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 27,076,717 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie për vitin 2024 për vlerën 27,076,717 **lekë konstatohet se:**

1-detyrimet për paga ndaj personelit, të pasqyruara në llogarinë 42”Personeli e llogari të lidhura me to”, në vlerën 18,706,693 lekë,

2-sigurime shoqërore në vlerën 6,482,234 lekë të pasqyruara në llogarinë 435” Sigurime shoqërore”,

3-detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa të pasqyruara në llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”, në vlerën 1,887,790 lekë,

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 3 (tre) llogarive pasive, pra në vitin 2024 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4.Nënrubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 136,649 lekë, kurse më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Përbërja analitike është si në aneksit nr. 3 si vijon:

Aneksi nr. 3 Shpenzime të periudhave të ardhshme

Nr	Emri i Furnitorit	Fatura		Shuma e papaguar ne 31 dhjetor 2024
		Nr.	Data	
1	A. Shpk	20	25.09.2023	0
	Shuma Totale 31.12.2024			0

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, është e kuadruar me shumën e llogarisë kreditore të pasivit të bilancit, respektivisht llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën totale 0 lekë në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 47,042,251 lekë, ndërsa më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 39,985,913 lekë, me diferencë në ulje në vlerën 7,056,338 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur për vitin 2024.

Kjo llogari është e analizuar si më poshtë vijon:

Aneksi,nr.4, pika 2, për projektet, studimet e kërkime dhe vlerat përkatëse, gjendje më 31.12.2024.

Nr	Llogaria 202	Gjendje ne fillim	Amortizim 15%	Gjendja fund 2024
1	Planifikimi i instrum vendore, Sheshi M. Mihali, Bregu Lumit	7,621,440	1,143,216	6,478,224
2	Studimi i territorit Maminas	5,204,989	780,748	4,424,240
3	Studimi Urbanistik i Territorit Xhafzotaj	3,400,000	510,000	2,890,000
4	Projekte rruge vepra ujore Xhafzotaj	5,071,100	760,665	4,310,435
5	Banesa sociale, projekt	3,570,000	535,500	3,034,500
6	Ndërtesa Bashkia RE,	4,590,000	688,500	3,901,500
7	Ambient çlodhës te shkolla M Dollaku	1,070,254	160,538	909,716
8	Rikon. rruge te brendshme Bashkia Shijak	-380,850	- 57,128	-323,723
9	Studim projekt 4 rrugët Pjeze	6,487,094	973,064	5,514,030
10	Rreth rrotullimi qendër Nj.ad Xhafzotaj	2,805,000	420,750	2,384,250
11	Studimi i Rrugës Ardhishte	-423,359	- 63,504	-359,855
12	Studimi i Rrugës ish fabrika e Niseshtesë	1,785,000	267,750	1,517,250
13	Hartimi i planit vendor Shijak	1,935,144	290,272	1,644,872
14	Ujësullësi Shijak SHA /Projekti	3051840	457,776	2,594,064
15	Hartezim toka/Projekti bujqësia	775200	116,280	658,920
16	Projekte Ndikimi ne Mjedis	479,400	71,910	407,490
	Gjendja ne fund te vitit 2024	47,042,251	7,056,338	39,985,913

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas auditimit përse janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, dhe tabelave të inventarizimit dhe amortizimit ku janë pasqyruar këto asete u konstatua se janë 2 (dy) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me vlerë kontabël negative gjë që është në kundërshtim me pikën Nr. 2.1, me “parmet e kontabilitetit në sektorin publik” të udhëzimit Nr. 8 i ndryshuar “për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Pika Nr.5 Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Pika Nr.6 (dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme). Pika Nr. 29-30 Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet

2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale,

-Gjendja e llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 25,654,385 lekë, në 31.12.2024 paraqitet po në vlerën 25,654,385 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi	Kosto historike
1	Shprone/ 2004 Varreza te reja Shijak	2,350,000
2	Shprone/ 2005 Varreza te reja Shijak	5,964,600
3	Shprone/ 2018 Varreza te reja xhafzotaj	1,697,500
4	Toka per Tregun Rural Xhafzotaj/2006	4,490,600
5	Toka per Tregun Rural Xhafz 2006 / Transf nga Komuna Xhafz	4,491,000
6	Toka te Salla e Lojrave me dore /2006	1,504,765
7	Truall funksional Ish spitali shijak/transf min mbrojtjes 2017	5,034,040
8	Shpronësim Lugina/Kapciu	121,880
	SHUMA 31.12.2024	25,654,385

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas regjistrimi përse janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje kullota plantacione” në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 4,830,000 lekë, në 31.12.2024 paraqitet po në vlerën 4,830,000 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Teprica neto 2023	Amortizimi 2024	Teprica neto 2024
1	Pyje Kullota	4,830,000	0	4,830,000
	TOTALI BASHKIA+NJESITE	4,830,000	0	4,830,000

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas regjistrimit përse janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja në llogarinë **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,144,279,396 lekë, më 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie rezulton 1,112,453,772 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar si vijon:

Aneksi nr.5, pika 2, Ndërtime e konstruksione, Pasqyrat Financiare, viti 2024.

NR	EMERTIMI 212 Ndërtime e Konstruksione	Pakesime				
		Dhjetor 2023	Am Vjetor 5%	Shtesa 2024	Pakesime	Dhjetor 2024
1	Ndertes e Bashkia Shijak	4,388,427	219,421			4,169,006
2	Ndert e Nj. Ad Maminas+ Kab elek	- 1,603,456	- 80,173			- 1,523,283
3	Ndertes e Nj.Ad Xhafzotaj	12,356,191	617,810			11,738,382
4	Ndertes e Nj.Ad Gjepalaj	3,603,297	180,165			3,423,132
5	Shk mesme16 Shtatori	78,243,254	3,912,163			74,331,091
6	" L.Prizrenit / P Llaftiu	148,175,520	7,408,776			140,766,744
7	" M. Dollaku	57,184,034	2,859,202			54,324,832
8	Kopeshti Nr.1	37,832,658	1,891,633			35,941,025
9	" Nr.2	33,395,299	1,669,765			31,725,534
10	Shkolla Maminas	130,582,495	6,529,125			124,053,370
11	shkolla e mesme	- 3,713,969	- 185,698			- 3,528,271
12	Shkolla Metallaj	651,338	32,567			618,771
13	Shkolla Rrubjeke	15,838,097	791,905			15,046,192
14	Kopeshti Karpen	270,733	13,537			257,197
15	Kopeshti RRubjeke	546,984	27,349			519,635
16	Shkolla 9 vjecare RRETH	6,889,147	344,457			6,544,690
17	Shkolla 9 vjecare Adem Sabli	62,317,305	3,115,865			59,201,440
18	Shkolla Rilindja Sallmone Rindertimi	113,333,197	5,666,660			107,666,538
19	Shkolla Xhafzotaj	70,011,404	3,500,570			66,510,834
20	Shkolla Gjepalaj	20,122,695	1,006,135			19,116,561
21	Shkolla Ardhishte	39,242,061	1,962,103			37,279,958
22	Shkolla Shtraze	35,289,557	1,764,478			33,525,080
23	Fusha e volejbollit	19,558	978			18,580
24	Fusha e Futbollit	3,174,520	158,726			3,015,794
25	Rrethim Fusha Futbollit	5,426,345	271,317			5,155,028
26	Drenazhim I Fushes Futbollit	3,331,525	166,576			3,164,949
27	Fushe sportive ne Shkollen 9- vjecare "Rilindja	5,123,448	256,172			4,867,276
28	Xhafzotaj	925,966	46,298			879,668
29	Firma sip.Natoja	32,547	1,627			30,920
30	Thertorja	211,182	10,559			200,623
31	Banesat Rome	6,945,604	347,280			6,598,323
32	Xhafzotaj	3,533,059	176,653			3,356,406
33	K U Z Maminas	8,043,777	402,189			7,641,588
34	Sheshi Maminas	3,982,256	199,113			3,783,143
35	Pallati kultures/2022	150,854,232	7,542,712	22,965,700		166,277,221
36	4 Pallate rindertimi rikonstr	10,167,749		1,914,259		12,082,008
37	Rrethimi varrezave	1,952,173	97,609			1,854,564
38	Lapidari ne qender te sheshit	506,226	25,311			480,915
39	Imazheria RO Spitali Shijak	4,479,269	223,963			4,255,305
40	Qendra e te moshuarve PAK	19,183,455	959,173			18,224,282
41	Qendra e Femijeve PAK	5,779,281	288,964			5,490,317
42	Ambulanca cizmeli	3,974,263	198,713			3,775,550
43	Ambulanca Shahinaj	3,393,770	169,688			3,224,081
44	Ambulanca Ardhishte	4,028,426	201,421			3,827,004
45	Ambulanca Kenete	4,153,498	207,675			3,945,823
46	Qender Shendets Gjepalaj	17,323,056	866,153			16,456,903
47	Ambulanca Rrubjeke	- 527,268	- 26,363			- 500,905
48	Ambulanca Karpen	300,630	15,031			285,598
49	Ambulanca Bodinok	393,432	19,672			373,761
50	Ambulanca Bilalas	983,923	49,196			934,726
51	Ambulanca Metallaj	989,490	49,475			940,016

52	Ambulanca Vlashaj	956,567	47,828			908,739
53	Ambulanca Maminas	5,925,273	296,264			5,629,010
54	Xhafzotaj	3,755,893	187,795			3,568,098
Shuma 212		1,144,279,395	56,705,582	24,879,959	-	1,112,453,772

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas auditimit përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, dhe tabelave të inventarizimit dhe amortizimit ku janë pasqyruar këto asete u konstatua se janë 3 (tre) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me vlerë kontabël negative gjë që është në kundërshtim me pikën Nr. 2.1, me “parmet e kontabilitetit në sektorin publik” të udhëzimit Nr. 8 i ndryshuar “për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Pika Nr.5 Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përphje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Pika Nr.6 (dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme). Pika Nr. 29-30 Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet

-Gjendja në llogarinë **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 2,277,353,133 lekë, më 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,280,537,504 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Aneksi nr.6, pika 2, Rrugë rrjete e vepra ujore, Pasqyrat Financiare, viti 2024.

Nr	Rrugë Rrjete / 213	Gjendje ne fillim	Amortizim 5%	Shtesa /2024	Pakësime 2024	Gjendja fund 2024
1	Rrugët transfer nga Ndërmarrja	34,873,163	1,743,658			33,129,504
2	Rruge te brendshme		-	32,854,535		32,854,535
3	Rehabilitimi 7 rrugëve te brendshme		-	28,103,588		28,103,588
4	Rrugët ish Fabrika Niseshtes	2,822,392	141,120			2,681,272
5	Unaza madhe Spitali Policia Vareza te reja	51,552,503	2,577,625			48,974,878
6	Rruga " Dum Alla"	1,449,325	72,466			1,376,859
7	Asfal Rruga Rexhep Keci	27,340,500	1,367,025			25,973,475
8	Rruga e Shkollave	78,261,246	3,913,062			74,348,184
9	Kuartalla	48,467,454	2,423,373			46,044,082
10	Rruga "Partizani"	19,657,288	982,864			18,674,424
11	Lagje " Kodra"	17,929,610	896,481			17,033,130
12	Rruga e Kasëve	23,853,094	1,192,655			22,660,440
13	Projektet e rrugëve	2,214,733	110,737			2,103,997
14	Sheshi hyrja e qytetit	7,596,469	379,823			7,216,646
15	Pemëtari lagje" Lugina"	1,536,998	76,850			1,460,148
16	Rehabilitimi I Lugines	19,790,897	989,545			18,801,352
17	Mbushje gropash	2,855,033	142,752			2,712,281
18	Hapësire Rekreative (Parku)	33,700,201	1,685,010			32,015,191
19	Rruga" 8 Marsi	13,617,944	680,897			12,937,047
20	Cakull rruge te brendshme	4,198,254	209,913			3,988,342
21	Ura Gjepalaj	2,521,678	126,084			2,395,594

22	Rruga "Gani Keta"	12,281,469	614,073			11,667,396
23	Qendra Qytetit Shijak	80,096,269	4,004,813			76,091,455
24	Rruga " Bregu Lumit dhe Sallmone"	6,195,897	309,795			5,886,102
25	Rruga " Mihal Mihali"	17,683,266	884,163			16,799,102
26	Lagja Vjetër Pusi Kecve	44,350,002	2,217,500			42,132,502
27	Rrugë të brendshme Xhafzotaj	7,075,333	353,767			6,721,567
28	Rrugët,Bilalas,Rrubjekë,Karpen	583,276	29,164			554,113
29	Rruga eLagja Rrubjeke	67,754,217	3,387,711			64,366,506
30	Rehab I rrugeve Metallaj maminas		-	41,042,032		41,042,032
31	KUZ Ardhisht	2,967,654	148,383			2,819,271
32	Rruget e Nj.Ad .Gjepalaj	1,083,830	54,192			1,029,639
33	Rruget e Nj.Ad .Gjepalaj	20,696,431	1,034,822			19,661,610
34	Rruga e fshatit Ardhishte	40,413,491	2,020,675			38,392,816
35	Rruga Lagje Kokomanëve	75,755,027	3,787,751			71,967,275
36	Rruga Shahinaj	9,951,254	497,563			9,453,692
37	Rruga Shahinaj -Gjepale	13,022,724	651,136			12,371,588
38	KUZ Begtesh	2,770,969	138,548			2,632,420
39	KUZ Ardhishte	14,117,698	705,885			13,411,814
40	KUZ/ Sallmone Xhafzotaj	87,870,333	4,393,517			83,476,817
41	Kanali Ujitës Gjepale	16,886,942	844,347			16,042,595
42	Kanale kulluese Hardhishte	11,496,838	574,842			10,921,997
43	Kanale kulluese Maminas	6,997,448	349,872			6,647,576
44	Kanale kulluese Rreth-Ardhishte	50,362,007	2,518,100			47,843,907
45	Shpim Pusi Likeshe	12,159,840	607,992			11,551,848
46	Rruga Eminas	11,660,218	583,011			11,077,207
47	Rruga Shetel	3,168,964	158,448			3,010,515
48	Rruga Shtraze	1,979,621	98,981			1,880,640
49	Rruga Kënetë	3,161,478	158,074			3,003,404
50	Rruga Karpen	18,212,139	910,607			17,301,532
51	Rruga Maminas	10,503,658	525,183			9,978,475
52	Lagje Gjecëve	571,111	28,556			542,555
53	Rruga Varreza Karpen	1,186,366	59,318			1,127,047
54	Rruga Varreza Karpen	1,053,358	52,668			1,000,690
55	Rruge Varreza Maminas	2,576,554	128,828			2,447,727
56	Rrubjeke	6,568,904	328,445			6,240,459
57	Karrec	757,920	37,896			720,024
58	Bilalas	5,595,676	279,784			5,315,892
59	Qendra Maminas	888,552	44,428			844,125
60	Rruga Gjergji	2,614,585	130,729			2,483,856
61	Rrjeti Ujësjiellës Shijak	303,098,495	15,154,925			287,943,570
62	Depo Ujit Maminas tubi fi 400	239,597,161	11,979,858			227,617,303
63	Ujësjiellës Bodinot	41,604,324	2,080,216			39,524,108
64	Ujësjiellës Vlashaj	2,993,404	149,670			2,843,734
65	Ujësjiellës Maminas	11,959,356	597,968			11,361,389
66	Ujësjiellës Gjepale sahare uji	556,676	27,834			528,843
67	Rrugët Xhafzotaj	468,218,600	23,410,930			444,807,670
68	Rr ish SMT deri tek Memoci	81,821,172	4,091,059			77,730,114
69	Ndricim Pjeze	1,428,922	71,446			1,357,476
70	Skema Kulluese DRK-7	13,957,490	697,874			13,259,615
71	Skema Kulluese DRK-2	2,018,961	100,948			1,918,013
72	Skema Kulluese DRK-14	4,000,755	200,038			3,800,717
73	Skema Ujtese DRU-5	847,373	42,369			805,004

74	Skema Ujitesë DRU-2	2,993,382	149,669			2,843,713
75	Rezervuari Likeshë	8,658,698	432,935			8,225,763
76	Rezervuari Bilalas	8,982	449			8,532
77	Rezervuari Karpen	891,499	44,575			846,924
78	Rezervuari Rrubjekë	7,827,052	391,353			7,435,699
79	Rezervuari Callikes	7,028,566	351,428			6,677,138
80	Rezervuari Shijak	302,395	15,120			287,276
81	Perroi Gjepalaj deri tek Pallati Jashareve		-	15,051,873		15,051,873
82	Rezervuari Metallaj	10,229,767	511,488			9,718,279
	Gjendja ne fund te vitit 2024	2,277,353,133	113,867,657	117,052,028	-	2,280,537,504

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja e llogarisë **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 21,574,429 lekë, më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 20,170,863 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas inventarit fizik.

Nr	Emertimi	gjend. ne fillim	shtesa	pakesime	Amortizimi 25%	gjend. ne fund
1	Menca	662,951			132,590	530,360.58
2	Laboratore	329,625			65,925	263,699.81
3	Kompjutera	- 2,341,469			- 468,294	(1,873,175.04)
4	Printera	- 1,381,529			- 276,306	(1,105,222.92)
5	Te tjera	24,304,851	2,911,320		4,860,970	22,355,200.83
	Gjendja në fund të vitit 2024	21,574,429	2,911,320	-	4,314,886	20,170,863

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, dhe tabelave të inventarizimit dhe amortizimit ku janë pasqyruar këto asete u konstatua se janë 2 (dy) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me vlerë kontabël negative gjë që është në kundërshtim me pikën Nr. 2.1, me “parmet e kontabilitetit në sektorin publik” të udhëzimit Nr. 8 i ndryshuar “për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Pika Nr.5, Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Pika Nr.6 (dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme). Pika Nr. 29-30 Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet

-Gjendja e llogarisë **215 “Mjete transporti”** më 31.12.2023 në vlerën 24,980,132 lekë, më 31.12.2024 në vlerën 23,731,126 lekë. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar si vijon:

Aneksi nr. 8 pika 2 i Mjeteve të Transportit sipas llogarisë 215 “Mjete transporti” viti 2024.

Nr	Emertimi	Vlera ne fillim	Amortizimi 5%	Vlera mbetur 2024
1	Eskavator	2,810,831	140,542	2,670,289
2	Range Rover /Ardian Kokomani	2,803,498	140,175	2,663,323
3	Furgon Policia Bashkiake	822,604	41,130	781,474
4	Kamiocine sherbimet	822,604	41,130	781,474
5	Zjarrfikse	2,782,112	139,106	2,643,006
6	Autovetura	228,155	11,408	216,747
7	Traktor lamburxhini	2,727,703	136,385	2,591,318
8	Traktor	342,781	17,139	325,642
9	Fadroma	2,354,735	117,737	2,236,998
10	Furgon Tatim TAKSA	342,781	17,139	325,642
11	Kamion pastrimi maminas	117,515	5,876	111,639
12	Autoveture Maminas	191,274	9,564	181,710
13	Autoveture Ardhishte	188,171	9,409	178,763
14	Autoveture Xhafzotaj	1,132,128	56,606	1,075,521
15	Autoboti i Zjarrfikses	1,520,053	76,003	1,444,050
16	Platforma/per ndricuesit	1,258,441	62,922	1,195,519
17	Zjarrfikse	2,614,592	130,730	2,483,863
18	Dacia Projekti BE per Qend PAK	1,920,154	96,008	1,824,146
Gjendja në fund të vitit 2024		24,980,132	1,249,007	23,731,126

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 5,078,852 lekë, më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 13,048,658 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera këtë vit dhe pakësime gjatë vitit 2024, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Nr	Emertimi	gjend. ne fillim	shtesa	pakesime	Amortizimi 25%	gjend. ne fund
1	Orendi paisje	530,728			132,682	398,046
2	komputera	2,521,495	9,239,520		630,374	11,130,641
3	Te tjera	2,026,628			506,657	1,519,971
Gjendja në fund të vitit 2024		5,078,852	9,239,520	-	1,269,713	13,048,659

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Për vitin 2024 gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pasqyrën aneks nr. 4 llogaritja e amortizimit)

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 242,600 lekë sipas vlerës nominale të aksioneve në Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sha.

Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitet 2024 rezultoi se: Bashkia Shijak, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 13/07/2022 paraqitet si aksionare me 2.43% të aksioneve të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha me NUIS “M22031502M” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 2.426 me vlerë nominale 100,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 242,600 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 2.43% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Shijak në “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha, është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2024, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në përputhje me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.
4.Nënrubrika, investime.

-Gjendja e llogarisë **231 “Për aktive afatgjata materiale”** më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë, në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Është investimi me objekt “Salla e lojërave me dorë” e nisur që në vitin 2004 me fondet e buxhetit të shtetit dhe në vijim nuk ka pasur asnjë financim tjetër. Si rezultat ky investim ngelet në këtë llogari për vlerën 18,948,027 lekë pasi nuk mund të kalojë në llogarinë 212 ku janë te pasqyruara ndërtesat e përfunduara te njësisë pasi nuk ka akt marrje në dorëzim te objektit.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2.Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nën-pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, “Aktive afatgjata jo materiale”.

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogarit e klasës 2 të aktiveve afatgjata; dhe

Do të kreditohet llogaria 109 “Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve

Aneksi nr. 9 pika 2 i Llogarisë 231 për “Aktivet afatgjata materiale” të cilat nuk janë marrë në dorëzim si dhe nuk kanë kaluar në llogaritë përkatëse të aktiveve.

Nr.	Emërtimi i objektit	Viti	Vlera sipas kontratës	Akti i Marrjes në dorëzim
1	Salla e lojërave me dore	2004	138,079,425	18,948,027
Vlera totale			138,079,425	18,948,027

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme. gjendja e llogarive të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 27,076,717 lekë për vitin 2024. E analizuar për vitin 2024 për vlerën 27,076,717 lekë përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2024
1	Paga Personeli llogaria 42	18,706,693
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	1,887,790
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	6,482,234
	TOTALI	27,076,717

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 3 (tre) llogarive pasive**, pra në vitin 2024 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 18,706,693 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	06.01.2025	13,467,883
2	06.01.2025	1,756,882
3	06.01.2025	1,876,875
4	06.01.2025	1,103,294
5	06.01.2025	349,481
6	06.01.2025	152,275
Totali		18,706,690

Nga auditimi u konstatua se paga neto e muajit dhjetor duhet të ishte në pasqyrën financiare me vlerë 18,941,060 lekë, sipas urdhër shpenzimeve është paguar vlera 18,706,690 lekë. Është deklaruar dhe është paguar vlera 234,370 lekë më pak. Kjo diferencë përbëhet nga 215,970 lekë nga pagat neto e cila është paguar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes Nr. 323/2 datë 29.03.2024, diferenca tjetër 18.340 lekë janë ndalesa të ndryshme mbi pagën.

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 1,887,790 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
11	08.01.2025	1,393,979
37	10.0.2025	498,692
Totali		1,892,671

Nga auditimi u konstatua se detyrimet për tatim taksa për muajin dhjetor duhet të ishin në pasqyrën financiare 1,896,524 lekë, e përbërë nga 1,397,832 lekë Tatim Page dhe 498,692 lekë Tatim në Burim.

Është vendosur në pasqyrë 8,724 lekë më pak.

Eshtë paguar sipas urdhër shpenzimeve 1,892,671 lekë dhe 5,853 lekë janë paguar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes Nr. 323/2 datë 29.03.2024, Është paguar vlera 2,000 lekë më shumë.

Deklarata e Tatimit në Burim është deklaruar në muajin janar 2025.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 6,482,234 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
7	08.01.2025	3,396,160
8	08.01.2025	2,224,891
9	08.01.2025	401,302
10	08.01.2025	401,301
12	08.01.2025	75,776
Totali		6,499,430

Nga auditimi u konstatua se detyrimet për sigurime për muajin dhjetor duhet të ishin në pasqyrën financiare 6,609,122 lekë., është vendosur në pasqyrën financiare vlera 126,888 lekë më pak.

Është paguar sipas urdhër shpenzimeve 6,499,430 lekë dhe 132,532 lekë janë paguar nga Agjencia Kombëtare e punësimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes Nr. 323/2 datë 29.03.2024,

Është paguar vlera 22,840 lekë më shumë.

-Gjendja e llogarisë 401-408 **“Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 2,355,754 lekë, te cilat i përkasin 5 subjekteve që i ka kaluar afati i pagesës dhe njësia duhet të marë masa për likuidimin e tyre, dhe 12 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor të likuidimin të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20.

Aneksi, nr. 10, pika 2, pasqyra e detyrimeve gjendje më 31.12.2024, për 12 subjekte të cilat janë brenda afatit 60 ditor të likuidimin të detyrimeve, dhe 5 subjekte që i ka kaluar afati i pagesës.

Nr	Emërtimi i furnitorit	Shuma totale	Ndarë sipas vitit të lindjes së detyrimit nga viti 2024 nga muaji dhjetor	
			datë fature	vlera
	Llog.401-408			
1	D. P.	120,042	2010	120,042
2	B. C.	28,650	21.11.2022	28,650
3	A. K.	303,480	18.11.2022	303,480
4	A. K.	91,752	18.11.2022	91,752
5	A. D.	20,000	26.12.2023	20,000
6	Sh. H.	97,000	27.12.2024	97,000
7	P. A.	18,900	30.01.2024	18,900
8	P. A.	15,120	29.05.2024	15,120
9	A. M.	10,450	07.06.2024	10,450
10	N. H.	304,200	11.07.2024	304,200
11	N. H.	178,800	11.07.2024	178,800
12	N. H.	222,600	11.07.2024	222,600
13	N. H.	123,000	05.08.2024	123,000
14	Sh. M.	151,200	16.08.2024	151,200

15	A. C.	200,880	02.09.2024	200,880
16	B.T.	299,880	15.10.2024	299,880
17	N.H.	169,800	12.11.2024	169,800
	TOTALI	2,355,754		2,355,754

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

-Gjendja e llogarisë 466 **“Kreditorë për mjete në ruajtje”**, më **31.12.2023**, paraqitet në vlerën 44,092,535 lekë, më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 39,584,878 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

Për vitin 2024 nga Bashkia, Drejtoria e financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2024 në vlerën 39,584,878 lekë për 20 subjekte. Gjatë vitit 2024 shtesat janë në vlerën **6,764,102 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **11,408,883 lekë për 10 subjekte**. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë Shijak dhe degës së thesarit Durrës.

Si përfundim konstatohet se: Për 13 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 1,997,454 lekë, sipas aneksit nr.11, pika 2, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap. III, pikat 30, 50.

pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”,

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Aneksi, nr. 11 ngurtësime, 5% gjendje 31.12.2024

Nr.	Emertimi I Objektivit	Subjekti	Gjendja	Shtesat	Pakesime	Gjendja
			31.12.2023	2024	2024	31.12.2024
1	Blerje pompe Ujesjellesi	R.	45,000			45,000
2	Sheshi para bashkise	D. Sh.p.k	114,493		114,493	0
3	Rruga Muharrem Dollaku	D.- .Sh.p.k	57,452		57,452	0

4	BANESAT SOCIALE	BOSHNJA KU	454,092			454,092
5	Ndertim I Shkarkuesve Katastr ne Rezervuare	D.	74,419		74,419	0
6	Sistemim I parceles nr 2 Varreza	D.	16,680			16,680
7	Lyerje e Shkollave dhe objekteve Shkollore	Sh. Shpk	203,783			203,783
8	Blerje Platforme Ajrore	R.M. shpk	133,800			133,800
9	Rikon dhe pershtat e Ambje ish Shkolles Ardhishte	H.	235,578			235,578
10	Sit Perf Rikualifik Lugina	A. A.	5,462			5,462
11	Rehab I rrugeve te brendshme ne shijak	A. A.		1,610,482		1,610,482
12	Rehabilitim I rrugeve ne Lagjen Metallaj, Karpen Bodinok Nj.Ad Maminas	L.		2,052,102		2,052,102
13	Ndertimi I Pallatit te Kultures	SH.		1,827,618		1,827,618
14	Rehabilitim sist ujites,gjepalaj	B.	277,560			277,560
15	Sistem ujites Maminas	B.	94,140			94,140
16	ZV Portave Metalike ne Rezervuarin e Callikes	S. shpk	162,360			162,360
17	Rehab. KUZ,Lagija Bektesh	S. shpk	137,403			137,403
18	Mobilim I zyrave te Bashkise Shijak	E. shpk	77,130			77,130
19	Rindertim I Shkolles 9 vjecare M Dollaku	E.	3,266,941		3,266,941	
20	Rifreskim I lyerjeve ne objektet arsimore	D.	101,203		101,203	
21	Rehabilitim I Kanalit Hardhishte Rreth	E.	1,283,303		1,283,303	
22	Ndertim I Shkolles 9 Vjecare Adem Sabli	E.	3,599,089		3,599,089	
23	Rehabilitim I Kanalit Hardhishte Rreth	E.	1,823,238		1,823,238	
24	Ndertim I Rrjetit te Ujesjellesit Per Qytetin e Shijakut	K. K.	16,580,991			16,580,991
25	Depo Ujit Maminas	K. K.	12,356,456			12,356,456
26	Ndertim I Shkarkuesve Katastrofik ne rezervuare	S.	154,466			154,466
27	Rehabilit I Sist Ujites Gjepalaj	V. H.	692,595		692,595	
28	Rehabitim I Rrugeve te Brendshme nr 1	A.	1,999,551			1,999,551
29	Rehabilitimin e Perroit te Gjepales,dhe i perroit nga Pallati i Jasharve deri tek Lumi Erzen"	D.		1,023,100		1,023,100
30	Takse Pulle		145,350	250,000	396,150	0
31						0
	TOTALI 466 dt 31.12.2024		44,092,535	6,764,102	11,408,883	39,447,754

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

Nga të dhënat e degës së Thesarit Durrës llogaria 466 në datën 31.12.2024 është në vlerën 39,625,586 lekë ndërsa në tabelën e pasqyruar gjendja në fund të periudhës është në vlerën 39,447,754 lekë, diferenca është 177,832 lekë. Kjo diferencë përbëhet nga vlera 137,124 lekë që i përket subjektit At. Shpk që është 5% i vlerës së punimeve dhe është paguar me urdhër shpenzimi Nr. 558 datë 31.12.2024 të cilën Thesari e ka pasqyruar në Janar 2025, ndërsa vlera 40,708 lekë është një diferencë e mbartur ndër vite.

Kontratat e lidhura për viti 2023-2024

Për vitet 2023 dhe 2024 janë kryer investime me burim financimi nga fondet e siguruar nga transfertat e pakushtëzuar, nga të ardhurat e veta dhe nga fondet e alokuara nga ministrinë e linjës e FSHZH. Në analizë këto investime paraqiten në *Aneksin nr. 12 i kontratave të investimeve për periudhën 2023-2024.*

Konkluzion: Për vitet 2023-2024 janë lidhur dhe zbatuar 10 kontrata në vlerën 418,447,249 lekë për blerje aktive materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Ministrinë linjës dhe FSHZH.

Me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) është bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", në kredi të llogarisë 404 "Furnitor për investime".

Në momentin e pagesave të faturave është kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 "Furnitorë për investime" dhe në kredi të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar".

Me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizmi aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhej prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Me kapitalizmin e aktivitet (për aktivitet e marra në dorëzim) duheshin kryer veprimet kontabël:
 - në debi të llogarisë 476 “te ardhura të caktuara për t’u përdorur” në kredi llog. 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime” dhe
 - në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit baze” në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Në **Kreun I** “Të përgjithshme” në **pikën 8** përcakton: “Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me:- Njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës”, në **Kreun II** “parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në **pikën 18/a** përcaktohet: “Për realizimin dhe njohjen e investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23); dhe- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4)”, në **Kreun III** “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në **pikën 32** përcakton: “**Kërkesat për arkëtim mbi debitorët, si dhe detyrimet të paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e evidentuar në kohën e lindjes së të drejtës dhe detyrimit. Në zbatim të nenit 61 të ligjit të buxhetit, lidhur me njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë:**

- **Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”).**

- **Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”.**

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampjonesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuara dhe të përdorura, të përlllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqëruar mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 40 “Shpenzimet” pika 1.

-Gjendja në llogarinë **467 “Kreditorë të ndryshëm”** më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 3,594,400 lekë, më 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie rezulton 3,357,400 lekë, e cilat përfaqëson gjendjen e letrave me vlerë të shpërndarë sipas personave përgjegjës dhe paradhënien nga Kopshte/Çerdhe.

Nr.	Subjekti	Emërtimi i investimit	Fatura		
			Nr.	Data	Vlera
	Bashkia Shijak	E. S. (Pulla)			1,918,000
	Bashkia Shijak	Xh. D. (Pulla)			96,000
	Bashkia Shijak	E. H. (Pulla)			144,000
	Bashkia Shijak	E. S. (Bileta Tregu)			573,500
	Bashkia Shijak	E. S. (Bileta Sporti)			120,000
	Bashkia Shijak	M. B. (Bileta Sporti)			127,900
	Bashkia Shijak	Paradhënie Kopshte/Çerdhe			378,000
Totali					3,357,400

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Shijak.

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2024 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.54 datë 23/12/202. Miratuar në total numri i punonjësve, 356 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 335 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Shijak është miratuar me Urdhër nr.105 datë 06.03.2024 nr. 1066 prot të Kryetarit të Bashkisë, i ndryshuar me Urdhër nr. 399 date 01.10.2024 nr. 4093 prot.

Sipas listë pagesave të muajve Shtator 2024, Dhjetor 2024 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. P. A. dhe nga Kryetari i Bashkisë Shijak z. E. A. deri ne 19/09/2024 sekretari i përgjithshëm T. Xh. në vazhdim.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës znj. P. A. dhe nga Kryetari Bashkisë; z. E. A..

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse e sektorëve respektive znj. S. B. (zyra Tatim Taksa), znj. J. G. (drejtoresha e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe shërbimeve publike), znj. P. A. (drejtorja ekonomike), z. M. G. (drejtori i bujqësisë), znj. D. Sh.(drejtoresha e kopshtit Nr. 1), dhe zyrat respektive e gjendjeve civile etj. dhe drejtoresha e Burimeve Njerëzore e bashkisë znj. E. Sh.

Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (kryesisht ato me arsim të lartë).

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicion, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

- Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër Motivimi; Dëshmi të tjera kualifikimi. Disa nga dosjet që u audituan:

Nr.	Emër Mbiemër	Paga sipas kategorive	Përvoja punë.
1.	N. Q.	IV-3	2
2.	A. V.	IV-3	5
3.	M. G.	II-2	23
4.	R. K.	IV-3	11
5.	S. G.	IV-4	10

Burimi i të dhënave: Drejtorja Ekonomike Bashkia Shijak.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2024

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Shtator 2024 dhe Dhjetor 2024) konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga znj. E. Sh. dhe kryetari i bashkisë z. E. A. Nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Shijak, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Shijak, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.
Sipas listë pagesave të muajve (Shtator 2024 dhe Dhjetor 2024) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.
Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. P. A. dhe sekretari i përgjithshëm z. T. Xh..

Në pasqyrën e performancës llogaria 6001 “Paga, personel i përhershëm” është vendosur vlera 225,562,161 lekë e cila përfshin pagat nga Dhjetori 2023 deri në Nëntor 2024.

Nga auditimi i formularit (esig 25) dhjetor 2023-nëntor 2024 në sistemin e tatimeve (e-filling), rezulton se paga totale bruto është në vlerën 228,769,074 lekë ndërsa në pasqyrën e performancës financiare, shpenzimet për paga janë në vlerë 225,562,161 lekë.

Në pasqyrën e performancës është vendosur shpenzime për paga vlera 3,206,913 lekë më pak, e cila i përket pagave bruto të punëmarsve të cilët janë paguar nga Projekti i Bashkimit European (shërbimi social për fëmijët me aftësi të kufizuar) me Nr. Kontrate IPA/2022/433-142 dhe nga Agjencia Kombëtare e Punesimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes Nr. 323/2 datë 29.03.2024

Në pasqyrën e performancës llogaria 6010 “Kontributi i sigurimeve shoqërore” është vendosur vlera 37,741,619 lekë e cila përfshin kontributet e sigurimeve nga dhjetori 2023 deri në nëntor 2024.

Nga auditimi i formularit (esig 25) dhjetor 2023 - nëntor 2024 në sistemin e tatimeve (e-filling), rezulton se Kontributet e Sigurimeve janë në vlerën 38,992,135 lekë ndërsa në pasqyrën e performancës financiare janë 37,741,619 lekë.

Në pasqyrën e performancës është vendosur shpenzime për kontribute sigurime shoqërore vlera 1,250,516 lekë më pak, e cila i përket kontributeve të sigurimeve punëmarrësve të cilët janë paguar nga Projekti i Bashkimit European (shërbimi social për fëmijët me aftësi të kufizuar) me Nr. Kontrate IPA/2022/433-142 dhe nga Agjencia Kombëtare e Punesimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes Nr. 323/2 datë 29.03.2024

Nga Bashkia Shijak mbulimi i shpenzimeve të pagave që është paguar nga Agjencia Kombëtare e Punesimit dhe Aftësive (AKPA), Nr. 323/3 prot datë 29.03.2024, dhe nuk është pasqyruar në grantet e përfituara, pika Nr. 2.6 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, punëdhënësit i disbursohet 20% e grantit sipas pikës 4 te kreut IV “Mbështetja e përfituesve” të VKM Nr. 535, datë 08.07.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e punëve publike në komunitet.

Eshte në kundërshtim me “pamet e kontabilitetit në sektorin publik” të udhëzimit Nr. 8 i ndryshuar, pika Nr. 47, (a) “per grantet e përdorura per shpenzimet e paguara”

***Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjoha të policisë Bashkiake. Nga arka janë kryer 10 veprime tërheqje me cek për shumën 1,618,690 lekë, duke i korinspoduar 10 veprimeve për pagesa, të cilat janë: MP Nr. 1 datë 27.02.2024 pagesë për bursat e nxënësve për vlerën 956,460 lekë,; MP Nr. 6 datë 03.12.2024 pagesë për kthim paradhënie për kopshte dhe çerdhe për vlerën 93,000 lekë, MP Nr. 2-3-4-5-7-8-9-10 për vlerën 669,684 lekë i perkasin pagesave për projekte artistike të zhvilluara gjatë vitit 2024 në bashkinë Shijak. Për të cilat është mbajtur vlera 100,454 lekë

Tatim ne Burim. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2024, janë prerë 3482 Mandat Arkëtime në vlerë 39,451,607 lekë .

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin, 2024 janë derdhur në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Pukë për të ardhurat.

Mallra dhe shërbime (llogaria 602)

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara elektronikisht nga specialisti i financës, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues, dhe të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me formatet e sistemit të thesarit për çdo muaj. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet thesarit sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Informacion mbi buxhetin:

Bashkia Shijak, mbështet veprimtarinë në kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin e vitit 2024 të datës 19.03.2025, të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2025-2027, buxheti fillestar 2024, buxheti i rishikuar 2024 dhe realizimi i buxhetit 2024. Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Shijak, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për shpenzime dhe investime nuk janë realizuar për shkak të mos analizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, kryesisht për mosrealizim të të ardhurave.

- Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak shpenzimet janë realizuar në masën 71%, ku nga vlera e planifikuar prej 759,159 mijë lekë, është realizuar vlera 220,843 mijë lekë, nga të cilat:

Shpenzime për investime në vlerën 114,530 mijë lekë; shpenzime operative në vlerën 86,641

mijë lekë; shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 19,672 mijë lekë.

-Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak të ardhurat janë realizuar në masën 75%, ku nga vlera e planifikuar prej 282,581 mijë lekë, është realizuar vlera 211,587 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pikat 6, 97, 101 dhe 103 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; nenet 34, 36 dhe 38, të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; si dhe pikën 8, Kreu 1, në UMFE nr. 8, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar

***Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.**

3.1 Bashkia Shijak është njësi e vetme shpenzuese.

3.2.Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.

Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë dhe analizën e llogarive të pasqyruara dhe të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit janë trajtuar hollësisht në pikën një të programit, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.3.Opinionin mbi pasqyrat financiare.

Për vlerësimin dhe dhënien e opinionit të pasqyrave financiare për vitin 2024, u analizuan të gjithë treguesit e aktivitetit të veprimtarisë ekonomiko financiare dhe në mënyrë përmbledhëse do të paraqitet së bashku me opinionin në raportin përfundimtar të auditimit.

Konstatime lidhur me regjistrin e aktiveve dhe procesin e inventarizimit të aktiveve.

-Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me inventarizimin e aktiveve në fund të vitit, u konstatua që Bashkia Shijak nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve në përputhje udhëzimin përkatës.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të inventarizimit për periudhën 2024 u konstatua se fletët e listave të zërave të aktiveve, nuk kanë përshkrime të sakta dhe identifikuese të aktiveve pjesë e procesit të inventarizimit duke mos dhënë siguri për materialet e tjera. Komisionet e inventarizimit të aktiveve nuk kanë përpiluar raportin përkatës për të ja dorëzuar Nëpunësit Autorizues.

-Në lidhje me aktivet u konstatua se nga institucioni nuk është kryer procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuar për dalje nga përdorimi për periudhën 2024. Bazuar në të dhënat kontabël janë gjendje aktive të cilat kanë mbaruar ciklin e përdorimit, nuk janë më në gjendje pune ose në përdorim. Për këto aktive nga institucioni nuk është iniciuar procesi i vlerësimit të tyre për të gjykuar për kosto-përfitimin dhe zëvendësimin e tyre.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pikat 5 e 95 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

- Bashkia Shijak, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivitetit, shënimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e daljes në përdorim

duke e bërë të vështirë përlllogaritjen e vlerës së mbetur.

Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vijimësinë e saj.

Mos plotësimi i regjistrimit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

II. Baza ligjore.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe zbatimi i rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr.44,

UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”,

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2.3. Verifikimi i ecurisë së rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në zbatim të pikës 3. të programit të auditimit: “Verifikimi i ecurisë së rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

-Plani i masave i marrë nga Bashkia Shijak për zbatimin e rekomandimeve

-Realizimi i masave për zbatimin e rekomandimeve

Nga verifikimi i dokumenteve rezultoi:

3.1.Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

3.2.Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

3.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Shijak nga KLSH me shkresën nr. 357/8 prot. datë 15.07.2024.

Drejtimit e Auditimit:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shijak rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 357/8, ndërsa nga Bashkia Shijak për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga titullari i bashkisë është urdhëruar me shkresën nr.3005 Prot., datë 19.07.2024, përgatitja e programeve për zbatimin e rekomandimeve me afate dhe personat përgjegjës për ndjekjen si dhe është dërguar në KLSH për njohje, plani i masave me shkresën nr. 3158 prot., datë 30.07.2024 brenda afatit 20 ditor.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shijak rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 1945/1 Prot. datë 07.05.2025 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). Nuk është bërë raportimi 6 mujor.

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

-Nga verifikimi rezulton se Bashkia Shijak ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 3158 prot., datë 30.07.2024 por ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.”

Ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, më datë 01.10.2024.

Objekti i verifikimit është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin e auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Shijak me Nr. 357/8 Prot, datë 15.07.2024. “Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023– 31.12.2023”, pika 3 e Programit të Auditimit, “Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm” rezultoi si më poshtë vijon: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar nga KLSH:

janë lënë gjithsej 66 rekomandime, të grupuara në:

-16 masa organizative;

-8 masa shpërblim dëmi;

-2 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

-1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

-14 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 1 është zbatuar, 12 janë në proces zbatimi, dhe 3 nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 8 rekomandime, të cilat 3 janë në proces zbatimi, 4 janë zbatuar dhe 2 nuk është zbatuar.

-Për uljen e borxhit tatimor janë lënë 2 rekomandime të cilat nuk janë zbatuar.

-Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara është lënë 1 masë e cila nuk është zbatuar.

-Për masa disiplinore janë lënë 14 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 14 dhe janë lënë pa zbatuar 4.

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk kuptohen dhe zbatohen plotësisht disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK-së:

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar, nuk ka një rregullore për funksionimin e tij;
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese në këtë sistem;
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara në sektorë të ndryshëm;
- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë së saj.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 13, 14, 16, 22, 23 dhe 24. (Më hollësisht trajtuar në faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, të marrë masa për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, njohjen dhe zbatimin nga stafi të ligjit për MFK-në dhe komponentëve të tij; Miratimin e planit vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, hartimin e regjistrave të riskut nga të gjitha drejtoritë, si dhe regjistrin e integruar të riskut, organizimin e programeve të trajnimit nga vetë institucioni, për ngritjen profesionale të stafit, në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të menaxhimit të riskut.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Titullari i BSH ka ngritur Urdhrin e brendshëm nr 63, prot. datë 08.02.2024 “Për delegimin e detyrave tek koordinatori i rrishtat”, Urdhrin nr. 64 datë 08.02.2024 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”, Urdhrin nr 64/1 datë 26.01.2024, Urdhrin nr. 62 datë 08.02.2024, Urdhrin 17 datë 11.01.2024. Bashkia Shijak me nr. 911/2 prot datë 28.02.2024 ka miratuar regjistrin e riskut. Për GMS është bërë me dije dhe duke njohur strukturat përgjegjëse për hartimin e planit të menaxhimit të riskut i cili është plotësuar nga drejtoritë përkatëse.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për organizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Shijak, u konstatua se:

- Stafi i Njësisë së Auditit të Brendshëm vazhdon me strukturë jo të plotë, dhe ka nevojë për mbështetjen e herëpashershëm nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm, për të kryer auditime më të thelluara në objeksionet e veta, në funksionimin dhe njohjen e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Në mungesë të strategjisë së menaxhimit të riskut, Sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime bazuar në analiza dhe vlerësime objektive të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si procedurat e prokurimit publik dhe urbanistika.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, 19 20; Manualin e AB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë pika 2.6 nënpika (c) dhe pika 3.5, kapitulli III, “Drejtimit e auditimit”, kapitulli

IV pikat 4.1.7-4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1, kapitulli VI pika 6.1, Kapitulli VII, pika 7.1.1; VKM Nr.83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrin masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë, sipas strukturës së miratuar me 3 punonjës.

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Shijak, të marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, si dhe plotësimin me certifikatë auditi të punonjësit të pacertifikuar.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Sipas plan-veprimit të miratuar nga titullari i Bashkisë Shijak dhe Koordinatori Riskut sipas urdhrorit të kryetarit Nr.106, date 24.02.2023 “Mbi zbatimin e ligjit nr.10296, date 08.07.2010 per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Bashkinë Shijak drejtuar gjithë drejtorive dhe sektorëve” dhe email-it të datës 06.12.2024 (dërguar drejtorive dhe sektorëve vartës) janë marrë masat për njohjen e Ligjit të MFK duke vendosur në dispozicion dhe manualin e tij. Koordinatori i Riskut ka asistuar në fillimin e punës në dy drejtori (taksat dhe drejtorja bujqësisë) për hartimin e regjistrimit të riskut (aktualisht akoma të miratuar) me trajnime të vazhdueshme në lidhje me identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Ka filluar puna për hartimin e regjistrave të riskut për çdo drejtori dhe sektor me qëllim përgatitjen e regjistrimit të Integruar por ka akoma hartim të pjesshëm dhe jo në nivel Bashkie i regjistrimit të riskut e i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut. Njësia e auditit të brendshëm në 6 mujin e dyte të vitit 2024 ka funksionuar me 1(një) përgjegjës, dhe 1(një) specialist. Në muajin Mars 2025 struktura e auditit të brendshëm është plotësuar me 3 punonjës. Stafit i Njesisë së Auditit të Brendshëm përgjatë vitit 2024 ka vazhduar me strukturë jo të plotë, dhe si pasojë nuk janë kryer të gjithë auditimet që janë planifikuar në Planin Strategjik dhe vjetor të auditit të brendshëm për vitin 2024. Planifikimet e auditimeve për vitin 2024, 2025 janë bërë duke u bazuar në analiza dhe vlerësime objektive të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat janë vlerësuar fusha me risk të lart si procedurat e prokurimit publik, lejet e ndërtimit, detyrimet e prapambetura, të ardhurat nga mbledhja e taksave vendore.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Shijak për vitin 2023, u konstatua se mbikëqyrja e pastrimit të qytetit nuk ka qenë periodike dhe e dokumentuar nga supervizori, pasi:

- mungojnë procesverbalet ditore me nënshkrimet e përfaqësuesit të kompanisë sipërmarrëse, për vërejtjet e konstatuara dhe punën e pakryer për çdo zë pune sipas zonave dhe rrugëve.

- mungon informacioni i plotë mujor.

- nuk pasqyrohen zbritjet për ditët me shi, pasi ato janë pasqyruar të plota në situacion me nga 30 dhe 31 ditë/muaj.

- nuk janë zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet e rrugëve e trotuareve të qytetit të kryera gjatë vitit 2023, konkretisht: për investimin “rregullimin e rrugëve të brendshme Shijak”, sipas kontratës 19.05.2023, situacionit nr. 4, rezulton vlera **35,162 leke punë e pakryer** për “A” ShPK, konkretisht:

-Zëri fshirje rrugë të brendshme për sipërfaqen $5,720 \text{ m}^2 \times 0.19 \text{ lekë/njësi} \times 31 \text{ ditë} = 33,690 \text{ lekë}$.

-Zëri fshirje rrugëve të brendshme për sipërfaqen $250 \text{ m}^2 \times 0.19 \text{ lekë/njësi} \times 31 \text{ ditë} = 1,472 \text{ lekë}$.

Veprime në kundërshtim me pikën 18.4/5/i dhe pikën 18.4/6/e të rregullores së brendshme të bashkisë e miratuar në këshillin bashkiak, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik” (Më hollësisht trajtuar në faqet 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria e Financës të marrë masa:

- Për mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit periodikisht duke mbajtur çdo ditë procesverbale ditore dhe informacione mujore nga supervizorët, me nënshkrimet e kompanisë sipërmarrëse.
- Për zbritjen në situacionet e radhës të vlerës **35,162 lekë** shërbim e pakryer, për firmën e pastrimit “A” Shpk, për përfitim të padrejtë të pagesës të fshirjes së rrugëve brenda qytetit, të cilat kanë qenë të zëna nga rikonstruksionet e rrugëve të brendshme të qytetit gjatë vitit 2023.

Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Shijak për vitin 2023, u konstatua se:

- Për 3 autoveturat jo në gjendje pune nuk disponohen procesverbale me specialistë të fushës, për efekt të riparimit ose shkarkimit të tyre nga kontabiliteti sipas procedurave ligjore, mjete të mbartura nga ish-komunat Gjepalaj, Maminas dhe Xhafzotaj.
- Dokumentacioni për shpenzimet në rindërtimin e shtëpive nga pasojat e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 nuk është i arkivuar dhe i inventarizuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe me rregulloren “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria e Financës të marrë masa:

- Për verifikimin me specialistë të fushës të gjendjes së 3 autoveturave jo funksionale, mbi bazën e të cilit të vendoset për rregullimin ose nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre, sipas procedurave ligjore.
- Për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve për rindërtimin e shtëpive nga pasojat e tërmetit të datës 26.11. 2019.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bilancit të vitit 2023 të Bashkisë Shijak, u konstatua se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 158,876,381 lekë, në mënyrë analitike: vlera 27,538,200 lekë debitor Bashkia Shijak, vlera 1,863,919 lekë debitorët e lënë nga KLSH dhe vlera 129,474,262 lekë debitorë të taksave vendore. Dinamika e debitorëve për vitin 2023 është në rritje për vlerën 38,656,369 lekë (2023=158,876,381 - 120,220,012 viti 2022), në vend që të ndodhte e kundërta. Bashkia për vjeljen e debitorëve ka bërë njoftime dhe bllokime në banka, veprim i cili ka dhënë efekte të pjesshme, por nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjor për arkëtimin e debitorëve prej 158,876,381 lekë, detyrime të pranuar dhe kontabilizuara nga bashkia, në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93, me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Taksave Vendore, Bashkia Shijak, të marrë gjitha masat duke ndjekur rrugët administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës të debitorëve prej **158,876,381 lekë**.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Ulje e vlerës për debitorët nga taksat e popullsisë dhe bizneseve në masën 148,077,785 lekë, sipas akt rakordimit me degën e thesarit Durrës.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për kontabilizimin e Aseteve të Bashkisë Shijak për vitin 2023 dhe regjistrimin e tyre në ASHK, rezultoi:

-115 prona të paluajtshme shtetërore nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, në kundërshtim me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësit vendore” neni 18, me ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifa e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pikat 20, 21, 22.

-54 prona të transferuara nuk janë regjistruar në kontabilitet, të cilat paraqiten në sipërfaqe dhe jo në vlerë, përkatësisht: varrezat, lapidarët, repartet ushtarakë, qendra shëndetësore, poliklinika, kabina elektrike, posta e re dhe e vjetër, lulishte, fushë grumbullimi e mbeturinave, truall mbi tokat bujqësore, etj, veprime në kundërshtim me ligjin 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin pronave paluajtshme publike Njësitë Qeverisjes Vendore”, me VKM 500 datë 14.8.2001 “Për inventarizimin PP Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë Vendore”.

Theksojmë se 61 prona janë të regjistruara në kontabilitet, si rezultat i pronave të transferuara me VKM nr. 44 datë 01.01.2011 dhe me VKM nr. 896 datë 21.12.2011.

-Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar nuk është regjistruar në ASHK. Sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, ndryshuar me VKM 684 date 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje e kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish-komunave/Bashkive”, i janë kaluar në pronësi Bashkisë Shijak me sipërfaqe gjithsej 427,2 ha, nga këto: Pyje 380,69 ha, Kullotë 16,35 ha, Toka joproductive 30,16 ha (tokë me bimësi pyjore) dhe Shkëmbore dhe ujore s’ka ha etj.

Nuk ka plan menaxhimi të ekonomisë pyjore të miratuar, por është planifikuar për vitin 2024.

Administrata e bashkisë i ka regjistruar në kontabilitet këto pasuri pyje e kullota.

Pronat në pronësi/përdorim të certifikuara ose jo nuk ka të lëshuar me kontratë qiraje.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria Juridike që mbulon Asetet, të marre masa:

-Për pajisjen me certifikatë pronësie të 115 pronave të paluajtshme shtetërore të bashkisë, duke aplikuar pranë ASHK Durrës.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Me urdhër nr. 423 prot., datë 22.10.2024 të Titullarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës nga Drejtoria Juridike ka vijuar procesi i regjistrimit të pronave shtet pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe pajisjen e tyre me certifikata pronësie.

Nuk është zbatuar

-Për regjistrimin në kontabilitet të 54 pronave të transferuara, sipas Aneksit nr. 5, përkatësisht: varrezat, lapidarët, repartet ushtarakë, qendra shëndetësore, poliklinika, kabina elektrike (30), posta e re dhe e vjetër, lulishte, fushë e grumbullimit të mbeturinave, truall mbi tokat bujqësore.

Nuk është zbatuar

-Për regjistrimin në ASHK të sipërfaqeve pyjore e kullosore.

Ka vijuar zbatimi sipas rekomandimeve të lëna pas shkresave nr 2779 prot datë 18.06.2025.

Është filluar procesi vetëm për një sipërfaqe prone.

Urdhri i titullarit nr 423 date 22.10.2024, rekomandim i cili është në vazhdim.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Shijak për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, me fond limit 148,938 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 134,562 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur

fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në **1 (një)** procedurë nga 7 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 8,333,333 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 8,333,333 lekë pa TVSh, konkretisht në procedurën me objekt “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Shijak”, rezulton se nuk është dokumentuar llogaritja e fondit limit, duke mos argumentuar nevojat reale për karburant sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

- Në **5** procedura nga 7 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 137,687 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në **4** procedura nga 7 të audituara, me vlerë kontrate 121,793 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Shijak Shijak, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Për llogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2, etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Shijak), të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Autoriteti Kontraktor ka marrë masat që për çdo procedurë prokurimi të zhvilluar Komisioni për Hartimin e Specifikimeve teknike dhe Përlllogaritjes së Fondit Limit të jetë me specialistë të fushës dhe një anëtar jurist si njohës i legjislacionit të prokurimit.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: -Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për punë publike, në 2 raste konkretisht për kontratat me objekt “Rikonstruksion i 7 rrugëve të brendshme të Bashkisë Shijak, Nj. Administrative Gjepalaj” dhe “Sistemimi i përroit të Gjepales (L=275ML) dhe i përroit nga pallati i Jasharëve deri në Lumin Erzen (L=90ML)” mungon oponenca teknike e projektit.

- Nga auditimi, rezulton në të gjitha rastet mungesë e inventarizimit, numerizimit dhe arkivimit të tyre të dosjeve të procedurave.

-Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit publik për investimet e realizuara për periudhën 01.01.2023–31.12.2023, ka rezultuar vonesë në përfundimin e shqyrtimit të vlerësimit të

ofertave nga KVO, i përcaktuar 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, duke sjellë vonesa të paargumentuara të procesit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 6 të ligjit me nr. 120/2020 *Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, me nenin 82, pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH"*, neni 8 germa (g).

(Më hollësisht trajtuar në faqet 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në bashkëpunim me personat e ngarkuar për menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, të marrin masa për të gjitha procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera e projektit, të mos vijohet pa marrë më parë miratimin nga institucionet e ngarkuara sipas ligjit për oponencën teknike të investimit.

- Personi përgjegjës për prokurimet, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimit e të gjitha dosjeve të mbyllura sipas të dhënave të sistemit të SPE dhe dokumenteve të administruara nga operatorët ekonomikë.

- Titullari i AK Bashkia Shijak, personat e ngarkuar si anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për kryerjen e vlerësimit të ofertave brenda afatit, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por për të shmangur çdo vonesë të paargumentuar që lidhet me shpenzimin e planifikuar nga Bashkia Shijak.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Bashkia Shijak ka zbatuar në vitin 2025 sa më sipër, nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit të Territorit janë kërkuar oponenca teknike për projektet në fushën e investimit publik. (shkresat). Nga ana e Personit Përgjegjës për Prokurimin është bërë e mundur inventarizimi i dosjeve të prokurimit të zhvilluara për vitin 2023 dhe vitin 2024. Janë marrë masat e nevojshme që asnjë procedurë mos të dalë jashtë afatit të përcaktuar të vlerësimit, rekomandimim i cili është realizuar plotësisht.

Rekomandimi për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të mbyllura nuk është zbatuar.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 u konstatuan mangësi që lidhen me zhvillimin e tyre nga komisioni përkatëse.

1. Në të gjitha rastet e testuara, konstatohet mungesa e kërkesës nga sektori përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;

2. Në të gjitha testet e kryera, rezulton mangësi në përllogaritjen e fondit limit, ku në 3 raste, pavarësisht se është pasqyruar nëpërmjet procesverbalit testimi i tregut, mungojnë **treguesit e këtij testimi**. Gjithashtu, në 5 procedura tjera, pavarësisht se është hartuar një preventiv për përllogaritjen e fondit limit, mungon argumentimi i kësaj përllogaritjeje;

3. Në procedurën e prokurimit blerje e vogël me objekt *"Blerje shtypshkrime dhe kancelari"*, kërkesat sipas ftesës për ofertë janë të tepërta, kjo referuar kërkesës për certifikatën ISO 2001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë). Nuk përcaktohet se çfarë ndikimi ka kjo ISO në raport me produktet që kërkohen. Në këtë procedurë, konstatohet se është kërkuar ndër të tjera edhe stilolapsa të tipit *shneider*, duke specifikuar markën e stilolapsit;

4. Në procedurën me objekt *"Pjesë këmbimi për ekskavatorin, mungon efektiviteti i kryerjes së këtij riparimi kapital, pasi kalon limitin ligjor mbi 25 % të vlerës së mbetur të mjetit 22 vjeçar prej 2,810,831 lekë;*

5. Në 5 procedura prokurimi blerje të vogla, konkretisht *"Blerje materiale ndërtimi"*, *"Blerje*

materiale elektrike”, “Blerje materiale pastrimi për nevoja të Bashkisë Shijak”, “Riparim i mjetit ekskavator KO MH5 Compact”, “Blerje shtypshkrime dhe kancelari”, “Blerje dhe shërbim për vendosjen e materialeve të dekorit të qytetit për festat e fundvitit”, janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e OE pasi nuk është paraqitur i plotë sipas Ftesës për Ofertë. Konkretisht, nuk janë paraqitur vërtetimet për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore. Në disa raste dokumentet e paraqitura si vërtetimet e taksave vendore, certifikatat ISO dhe faturat për likuidimin e energjisë elektrike, janë paraqitur fotokopje të panoterizuara.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 36, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, pika 2 germa (a), neni 76, pika 1 dhe 2, Udhëzimi nr. 5, datë 215.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Bashkia Shijak, Drejtoria Financiare dhe Sektori i Prokurimeve, në zhvillimin e procedurave me blerje të vogla, të marrë masat e mëposhtme:

- Të dokumentohen nevojat dhe kërkesat e institucionit që lidhen me nevojat për mallra dhe shërbime;
- Të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit duke vendosur edhe treguesit e çmimeve;
- Të shmangen kriteret e tepërta, pasi jemi në procedura me vlerë të vogël dhe kriteret të jenë sa më të thjeshta. Të bëhet kujdes maksimal me specifikimet teknike, duke shmangur markat e produkteve.
- Në rastet kur Operatorët Ekonomikë, nuk përmbushin kërkesat sipas Ftesës për Ofertë, të bëhet s’kualifikimi i tyre për mos përmbushje të kriterëve.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nisin me kërkesën nga sektorët përkatës përpara nisjes së zhvillimit të procedurës gjithashtu dokumentohen saktë sipas rastit përlllogaritja e fondit limit.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

10.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, në kundërshtim me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 12/ Neni 13, çka ndikon negativisht në balancimin e nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor, si dhe në krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 75-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak dhe Këshilli Bashkiak, të marrë masa për përfundimin e procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, dorëzimin dhe prezantimin e planit të përgjithshëm vendor pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe normat teknike të planifikimit, deri në miratimin e tij.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Bashkia Shijak ka marrë masa në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit të përfundojë hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Të dyja palët po bashkëpunojnë për hedhjen në GIS të të dhënave të Lejeve Të Ndërtimit të lëshuara në vitet 2015-2025. Informacion mbi projektet e zhvilluara etj. Shkresat me nr. 3943 prot date 30.08.2023 dhe shkresa me nr. 1409 pro.t date 26.03.2025.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

11.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** tek të cilat pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit për një tipologji të ndryshme nga ajo e pasqyruar në projektin e ndërtimit, përkatësisht për lejet e ndërtimit me objekt: 11.“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R” ShPK, në adresën rruga “F”, Xhafzotaj, Shijak; 2.“Kapanon industrial 1 kat + showroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak. “3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak. Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 16, përmbajtja e lejes së ndërtimit, pika 1/ë) përshkrimi i ndërtimit të miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 77-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: DPKZHT Shijak, përpara miratimit të lejeve të ndërtimit të shqyrtojë me vëmendje projektin e ndërtimit dhe relacioni teknik, për të përcaktuar saktë tipologjinë e ndërtimit dhe funksionin, në mënyrë që të jetë në përputhje me përshkrimin e lejes.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Zbatuar pasi DPKZHT Shijak kërkon për çdo aplikim dokumentacionin e plotë ligjor në zbatim të Rregullores së Planifikimit të Territorit. Ku shikohet me kujdes tipologjia e ndërtimit në përputhje me projektet e paraqitura. (është bere auditimi i brendshme për këtë drejtori).

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi miratimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, u konstatua se:

- Leja e ndërtimit me objekt “Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R” ShPK, në adresën rruga “F.”, Xhafzotaj, Shijak, ka mungesa në paraqitje e dokumentacionit të plotë të pronësisë, përpara miratimi të lejes të ndërtimit;

- Leja e ndërtimit me objekt “Kapanon industrial 1 kat + showroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati V., Rr. Maminas-Sukth, mungon oponenca teknike;

- Leja e ndërtimit me objekt “Kapanon industrial 1 kat + showroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati V., Rr. Maminas-Sukth, Shijak, ka mos respektim të distancave nga kufiri rrugor dhe nga kufiri i pronës;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në nenin 6, pika 1, germa (c); Ligjin 111/2018, për “Kadastrën”, datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4; VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, germa (c), me nenin 14, pika 2, neni 25, pika 2; VKM-në Nr.153, datë 07.04.2000, “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”,; VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 34, pika 12; neni 35.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 79-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Shijak të marrë masat si vijojnë:

- Verifikimin e dokumentacionit të pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në bazë të vendimit përkatës, si dhe paraqitjen e plotë të planvendosjes së miratuar dhe respektimin e distancave.

- Përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të verifikojë kryerjen e oponentëve teknike për të gjitha objektet që kanë akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre. Gjithashtu, të verifikohen me saktësi volumet e preventivit që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Zbatuar pasi për çdo aplikim verifikohet dokumentacioni ligjor siç është edhe oponenti teknike për objektet me vlerë preventivi mbi 100`000`000 lekë. Si dhe kontrollon planvendosja dhe distancat nga kufiri i pronës dhe rrugët apo objektet kufitare në zbatim të Rregullores së Planifikimit të Territorit. Bashkëlidhur oponenti teknike

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

13.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të certifikatave të përdorimit u konstatuan 2 praktika tek e cila pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit pa pasur dokumentacionin e nevojshëm të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe realizimin e objektit në terren në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, konkretisht në objektet: 1.“Kapanon industrial frigoriferik”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën S., Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak. 2. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot.,datë 06.10.2023, me zhvillues “B.T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42, Certifikata e përdorimit/ neni 51, Inspektimi; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27, certifikata e përdorimit; neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve; neni 27/2, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi dhe me Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 82-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Shijak të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit dhe për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura, si edhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe me destinacionin e përcaktuar.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Zbatuar pasi për çdo aplikim për certifikatë Përdorimi kërkohet dokumentacioni i plotë ligjor sipas rregullores së zhvillimit të territorit si dhe aktkontrollit e mbajtura nga subjekti zbatues, konformitetet e mbajtura nga Sektori i Planifikimit të Territorit, si dhe akti i mbajtur nga IMT për zbatimin e punimeve sipas Lejeve të miratuara. (Auditi i brendshëm).

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, rezultuan mangësitë si më poshtë:

-Një pjesë e stafit të rekrutuar nuk kanë arsimin e duhur, konkretisht 2 prej inspektorëve. Stafi i IMTV nuk ka inxhinierë, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit.

-Është aplikuar vendosja e masës së gjobës për objektet pa leje, por rezulton se ajo nuk është me përlllogaritje sipas vlerës së punimeve pa leje.

-Rezulton se janë nxjerrë 2 vendime për prishjen e ndërtimeve pa leje, por nuk është kryer ekzekutimi i këtyre vendimeve.

-Në asnjë rast për vitin 2023, nuk janë mbajtur aktet e kontrollit për objektet të cilat janë me leje ndërtimit, kjo edhe për shkak se stafi i IMTV nuk ka punonjës me profilin përkatës që lidhet me

inxhinierinë.

Mungojnë planet e miratuara mujore, si dhe nuk është dërguar informacioni 3 mujor pranë IKMT, për aktivitetin që ka kryer inspektorati.

Gjobat e vendosura, nuk janë përcjellë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Taksave për ndjekjen dhe kontabilizimin e tyre, nuk i janë përcjellë Drejtorisë Juridike për të kërkuar pranë Gjykatës Administrative kthimin e tyre në titull ekzekutiv.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, f), Ligji nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 “Inspektimi” neni 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1 germa (e), VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1 germa b/ii, pika 2, Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

- IMT Bashkia Shijak, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, të aplikojë masën e gjobës për ndërtimet pa leje sipas vlerës së punimeve, të marrë masa për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, dhe në rast se nuk disponon kapacitetet e nevojshme, të kërkojë bashkëpunimin e IKMT. Kryeinspektori i IMT, të hartojë planet mujore të punës dhe t’i miratojë ato tek Kryetari i Bashkisë, duke marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtyre planeve. Gjithashtu, të raportojë periodikisht çdo 3 muaj pranë IKMT për ecurinë e kontrollit.

- IMT Bashkia Shijak, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë e Taksave dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për ndjekjen e gjobave të vendosura, të bëjnë kontabilizimin e tyre, deri tek kërkesat gjyqësore për kthimin e tyre në titull ekzekutiv.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Zbatuar pjesërisht, nuk është bërë kontabilizimi i gjobave të vendosura, nga ana e IMT do të merren masat për të bërë dhe zbatimin e këtij rekomandimi të lënë.

Sa i përket stafit të IMT, nga ana e Bashkisë Shijak janë bërë thirrje të vazhdueshme për shkak se janë vende vakante për ing ndërtimi por pa sukses pasi nuk ka pasur subjekte të interesuara për këtë profil pune. (data e aplikimit te thirrjes).

IMT Shijak ka zbatuar rekomandimin sa i përket akteve të kontrolleve, planeve ,mujore, bashkëpunimit me IKMT dhe zbatimit ligjor.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Shijak me shkresën nr. 430/8 prot., datë 06.10.2023, ka rezultuar se:

- Nga Bashkia Shijak është respektuar afati 20 ditorë për kthim e përgjigjes, referuar shkresës nr. 1986/1, datë 26.10.2023, në zbatim të nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ndërsa në lidhje me afatin 6 mujor nga Bashkia Shijak nuk është marrë asnjë masë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Nga 34 masa organizative, të cilat janë pranuar nga Bashkia Shijak, janë zbatuar 19 masa, janë

në proces zbatimi 10 masa, është **zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 4 masa nuk janë zbatuar.**

- Janë rekomanduar 2 masa shpërblim dëmi në vlerën 883,220 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht.

- Janë rekomanduar 10 masa eliminimin e efekteve negative në administrimin e të ardhurave, të cilat janë pranuar, ku rezulton se 1 masë është zbatuar, janë në proces zbatimi 7 masa dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

- Janë rekomanduar 12 masa disiplinore, rekomandim i cili është zbatuar.

Sa më sipër, konstatohet se pavarësisht marrjes së masave për zbatimin e rekomandimeve, disa prej tyre nuk janë realizuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 Për Menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (Më hollësisht trajtuar në faqet 92-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

15.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Bashkia ka bërë trajnime të vazhdueshme të personave përgjegjës të cilët i kanë bërë me dije KVO për çdo rast e ligjit dhe kualifikimin e OE të cilët plotësojnë këto kriteret, sipas praktikave të realizuara është vënë re që ky rekomandim është përmbushur.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Rekomandime të periudhës së mëparshme.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

25.1. Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore.

-Nga ana e bashkisë Shijak është bërë thirrje për aplikim për vend pune dhe nuk ka patur kandidatë të interesuar.

26.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV. Do të meren masa në vazhdim .

27.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për të ndëshkuar kundërvajtësit e ligjit me masa administrative në raport proporcional me shkeljen e konstatuar. Në proces .

28.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak dhe IMTV të merren masa për hartuar dhe miratuar planet mujore të punës nga kryeinspektori, gjithashtu të hartojë dhe të dërgojë pranë IKMT raportimin tre mujor, sipas afateve të parashikuara në ligj.

K/Inspektori i IMTV ka hartuar planet mujore dhe i ka miratuar ato duke ja vendos në dispozicion inspektorëve.

2.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë ma sa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shijak Sh.a., për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

4.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Durrës vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

Rekomandimi nuk është zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Shijak, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **23,651,972 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i 7 rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak dhe Njësinë Administrative Gjepalaj” Bashkia Shijak, me vlerë 47,999,914 lekë me TVSH, fituar nga OE “A.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: (Zëri 7(3.229/2). Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri; Zëri 7(3.233/1). Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 4 cm, me makineri), në rrugët “8 Marsi”, “L. K.” dhe “Sh. Sh.”, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Shijak, në vlerën **504,218 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5836 prot., datë 22.12.2023 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shijak dhe shoqërisë “A.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 62-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Shijak në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **504,218 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Rekomandimi është realizuar plotësisht pasi është bërë pagesa nga OE A., e vërtetuar me bankën e muajit shtator datë 09.09.2024 nga Drejtoria Ekonomike.

Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit për kontratat për punë publike, u konstatuan disa problematika dhe, konkretisht:

I) Në kontratën me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme, Bashkia Shijak”, me vlerë

72,200,659 lekë me TVSH, fituar nga BOE “A.” ShPK & “H.” ShPK, rezultuan punime ndërtimi: (1) të pakryera në volumet e situacionuara, (2) punime të pa argumentuar me dokumentacionin provues/justifikues, për zërat e punimeve: [Cilindrim kasonete me rul (rrugë, trotuare, etj); Struktura monolite betoni C 12/15, mure vetë shtrënguese për pllakat, me pasojë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Shijak në vlerën **637,340 lekë pa TVSH** dhe punime ndërtimi jo në përputhje me specifikimet teknike (3); Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm. Biokomponentë (pastë); Pajisje për mbrojtjen e ndriçuesve LED nga shkarkimet atmosferike dhe tensionet akumulative nga driver, në vlerën **3,325,910 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2568 prot., datë 19.05.2023 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shijak dhe JV “A. & H.” SHPK.

II) Në kontratën me objekt “Rikonstruksion i 7 rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak dhe Njësinë Administrative Gjepalaj” Bashkia Shijak, me vlerë 47,999,914 lekë me TVSH, fituar nga OE “A.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara dhe konkretisht:

- Në rrugën “8 Marsi” zëri i punimeve “7 (3.229/2). Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri” u konstatuan punime me cilësi të dobët në volumin prej 27 m² në vlerën 32,400 lekë.
- Në rrugën “Latif Keci” dhe “Shaban Shahini” zërat e punimeve “Shtresë stabilizanti; shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm dhe shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe, 4 cm, me makineri” janë kryer punime me cilësi të dobët në volumin prej 28 m² në vlerën 91,420 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5836 prot., datë 22.12.2023 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shijak dhe shoqërisë “A.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 67-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Shijak në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **637,340 lekë pa TVSH** përfituar nga BOE “A. & H.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2568 prot., datë 19.05.2023, për punime të certifikuara dhe të situacionuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Rekomandimi është realizuar plotësisht pasi është bërë pagesa nga OE A, e vërtetuar me bankën e muajit shtator datë 09.09.2024 nga Drejtoria Ekonomike.

Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Shijak në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme, Bashkia Shijak” është në periudhë garancie deri me datë 21.12.2024, të marrë masa për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve për realizimin e zërave të punimeve “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm, Biokomponentë (pastë)” dhe “Pajisje për mbrojtjen e ndriçuesve LED nga shkarkimet atmosferike dhe tensionet akumulative nga driver”.

Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore dhe specifikimet teknike, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **3,325,910 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Bashkia Shijak nuk ka ngritur komision për të certifikuar kryerjen e punimeve.

Rekomandimi është zbatuar

2.3.Rekomandimi: Bashkia Shijak në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i 7 rrugëve të brendshme në

Bashkinë Shijak dhe Njësinë Administrative Gjepalaj” është në periudhë garancie deri me datë 05.03.2025, të marrë masa për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve për realizimin e zërave brenda periudhës së garancisë të punimeve “Shtresë stabilizanti; shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm dhe shtresë asfaltobetonit me zall lavatriçe, 4 cm, me makineri”. Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës 123,820 lekë, përfutur padrejtësisht nga Kontraktori “A.” SHPK, për punime të certifikuar, por të pa realizuara.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Rekomandimi është realizuar pasi është bërë pagesa nga OE Al Asfalt, e vërtetuar me bankën e muajit shtator datë 09.09.2024 nga Drejtoria Ekonomike.

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Riforcim i njërive të banimit në ndërtesat (Pallat), të pabanueshme nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me vlerë 21,514,459 lekë me TVSH, fituar nga OE “I” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punimeve: “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km”, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Shijak, në vlerën **304,140 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4068 prot., datë 08.09.2023 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shijak dhe shoqërisë “I” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 71-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Shijak në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **304,140 lekë pa TVSH** përfutur nga shoqëria “I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4068 prot., datë 08.09.2023, për punime të certifikuar dhe të situacionuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Rekomandimi është realizuar pasi vlera është arkëtuar përpara shlyerjes së detyrimit të situacionit përfundimtar e vërtetuar me bankën e muajit maj 2025 datë 06.05.2025.

Rekomandimi është zbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **3 praktika** tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mos llogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, në bazë të destinacionit dhe tipologjisë së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht në lejet me objekt: **1.** “Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F ”, Xh , Shijak, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **8,185,250 lekë**. **2.** “Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **3,100,936 lekë**. **3.** “3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **5,648,719 lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë; me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; me Vendimin e Këshillit Bashkiak Shijak, nr.74, datë 23.12.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shijak”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 81-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim, Kontroll Zhvillim Territorit Bashkia Shijak, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës prej 16,934,905 lekë, nga mos llogaritja e saktë e TNI, respektivisht për subjektet:

- vlera 8,185,250 lekë nga zhvilluesi “R.” ShPK;
- vlera 3,100,936 lekë nga zhvilluesi **Xh. T. dhe A. C.**
- vlera 5,648,719 lekë nga zhvilluesi nga zhvilluesi “M. M.” ShPK.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Bashkia Shijak ka marrë masa për të arkëtuar vlerën prej 16`934`905 lekë për subjektet duke iu çuar zyrtarisht njoftimet për pagesë subjekteve, ndër të cilat subjekti Shoq. “M. M.” ka shlyer detyrimin prej 5,648,719 lekë e vërtetuar me bankën e datës 08.08.2024 nga Drejtoria Ekonomike. Detyrimi është paguar vetëm nga “M. M.” ShPK, zhvilluesit e tjerë kanë bërë kërkesa për ndryshimin e objektit të lejes.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht dhe është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve me bankën të Bashkisë Shijak për vitin 2023, u konstatuan 2 raste me efekte financiare për vlerën 1,517,400 leke, nga kjo:

- Vlerën 469,000 lekë dëm ekonomik, konkretisht: vlera 466,000 lekë shpenzime të paligjshme për transport jashtë dhe brenda vendit, për dreka pritje-përcjellje, për persona jashtë organikës së saj, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999, sipas urdhër shpenzimit nr. 651 datë 29.12.2023, nr. 238 datë 12.05.2023, nr. 226 datë 08.05.2023, nr. 239 datë 24.05.2023, nr. 251 datë 30.05.2023. Vlera 3,000 lekë, likuiduar tepër subjekti “I” ShPK, sipas urdhër shpenzimit nr. 647, datë 21.12.2023, pasi është likuiduar vlera 10,167,749 lekë, në vend të vlerës 10,164,749 lekë, sipas situacionit nr. 1 dhe faturës elektronike nr. 19/2023 datë 16.11.2023, në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike.

- Vlerën 1,048,400 lekë e përfituar 2-herë TVSh, pasi në situacionet përkatëse subjekti zërin e pajisjeve “pajisjet elektrike, hidraulike, ndriçimit rrugor” i ka llogaritur me gjithë vlerën e TVSh, në vend që ti ndante veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa TVSh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e TVSh dhe duke i vënë në fund të situacionit, për objektet e investuara, veprim në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. Për rrjedhojë subjektet kanë përfituar 2-herë TVSH, pasi ajo është marrë edhe në fund të situacionit, përveç përfshirjes njëherë në brendi të situacionit si rezultat i mos-veçimit, konkretisht:

Vlera 326,400 lekë, subjekti “A.” ShPK, për objektin “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme”. Pajisjet dhe aparaturat elektrike paraqiten sipas situacionit për vlerën 1,632,000 lekë x 20 % = 326,400 lekë.

Vlera 722,000 lekë, subjekti “K. K.” ShPK, për objektin “Rikonstruksion i tubacionit të ujit Vorë – Shijak – fshatra”. Pajisjet hidraulike paraqiten për vlerën 3,635,000x20%=727,000 lekë.

Theksojmë se edhe në faturën e subjektit është marrë TVSH e pajisjeve.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 2.3 faqe 39-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,517,400 lekë**, konkretisht:

-Vlerën **469,000 lekë** dëm ekonomik, përkatësisht nga personat pjesëmarrës sipas listës në dokumentet e bankës dhe vlera **3,000 lekë** nga subjekti “I.” ShPK.

-Vlerën **1,048,400 lekë** përfituar 2-herë TVSh, përkatësisht: **326,400 lekë** nga subjekti “A.” ShPK, dhe vlera **722,000 lekë** nga subjekti “K. K.” ShPK.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

-Zbatuar pjesërisht, është bërë pagesa nga OE I.sh.p.k e vërtetuar me bankën e muajit Qershor datë 12.06.2025 nga Drejtoria Ekonomike.

-Për OE K. K. nuk është realizuar ky rekomandim.

-Për OE A. A. për shumën 326,400 lekë rekomandimi është realizuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht dhe është proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të automjeteve për vitin 2023, u konstatua se nuk disponohen fletudhëtime për 3 automjete, për pasoje nuk justifikohet me dokumente karburanti i harxhuar për vlerën 304,239 lekë, përkatësisht:

-Fuoristradë Range Rover me targa AA5670A, shpenzuar 550 litra naftë për vlerën 112,891 lekë;

-Furgon benz me targa AA567RE, shpenzuar 380 litra naftë për vlerën 73,930 lekë;

-Furgon benz me targa AA571RE, shpenzuar 610 litra naftë për vlerën 117,418 lekë;

(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masa për analizën e problemit të mos mbajtjes së fletudhëtimeve për 3 automjetet e administratës për vitin 2023, me qëllim arkëtimin e vlerës **304,239 lekë**.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Nga ana e Drejtorise Ekonomike janë njoftuar punonjësit për vlerën e lënë nga KLSH dhe janë marrë masat për arkëtimin e kësaj vlere, sipas ndalesave në bordero duke filluar nga muaji Maj 2025 me emërtimin ndalesë në page e vërtetuar me borderonë e muajit maj 2025, qershor 2025 dhe shkresave për njoftim të punonjësve. Ky rekomandim është në vazhdimësi dhe është realizuar pagesa në masën 120,000 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave vendore të Bashkisë Shijak për vitin 2023, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

Debitorët e taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 paraqiten për vlerën 129,474,262 lekë gjithsejtë, nga vlera 92,460,994 lekë në fillim të vitit, shtuar gjatë vitit 49,037,277 lekë, arkëtuar 12,024,009 lekë gjatë vitit, pra me tendencë në rritje.

Vlera debitorë prej 129,474,262 leke është kontabilizuar dhe kuadruar në pasqyrat financiare dhe ndahet në mënyrë analitike:

-vlerën 2,113,471 lekë, detyrime të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje gjithsej 30 subjekte.

-vlerën 17,000,000 lekë, detyrime të 17 subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitetin pa licencë të tregtimit të hidrokarbureve, në kundërshtim me nenin 35 ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me VKM 344 datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM 970 date 02.12.2015, pika 15.1.

-vlerën 110,360,791 leke, debitorë tjerë të taksave vendore përkatësisht: debitor të taksës së tokës bujqësore, debitor të biznesit të madh dhe biznesit të vogël të bashkisë dhe 3 Njësi Administrative Shijak.

Bashkia Shijak paraqet 20 subjekte të pa licencuara.

Mos arkëtimi i detyrimeve tatimore bie ndesh me nenin, 17, 34 të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” ndryshuar me ligjin 122/2020, me nenet 90, 91, 93, 111, 113 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” dhe pikat 3 dhe 5 të UP të MF dhe MPVD 5 datë 27.01.2003, pikat 10 të UMF nr. 655/1 datë 06.02.2007 “Për përcaktimin uniformitetit të Standardeve procedurale dhe raportimit sistemit taksës vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 27-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, me qëllim arkëtimin dhe sistemimin e debitorëve të taksave vendore për vlerën 129,474,262 lekë, përkatësisht:

-vlerën 110,360,791 lekë debitor të taksës tokës bujqësore, debitor të biznesit të madh dhe biznesit të vogël të bashkisë dhe 3 njësi administrative Shijak

-vlerën 2,113,471 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për 30 subjekte.

-vlera 17,000,000 lekë debitor për tregtimin e karburanteve pa licencë për 17 subjekte.

Ky rekomandim nuk është realizuar pasi debitorët e taksave vendore janë rritur

Taksat vendore nga 129,474,262 lekë, përkatësisht: 151,105,340 lekë,

-vlera 110,360,791 lekë debitor të taksës tokës bujqësore, debitor të biznesit të madh dhe biznesit të vogël të bashkisë dhe 3 njësi administrative Shijak në dhjetor 2024 është bërë 127,819,154 lekë.

-vlera 2,113,471 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për 30 subjekte, është rritur në 11,286,186 lekë.

-vlera 17,000,000 lekë debitor për tregtimin e karburanteve pa licencë për 17 subjekte është bërë 12,000,000 lekë minus 5,000,000 lekë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për vendosjen e gjobave për kundërvajtjet e kryera për ndërtime pa leje, rezultoi se janë vendosur 2 gjoba për 2 subjekte në vlerën totale 1,000,000 lekë, të cilat nuk janë kontabilizuar, dhe nuk i janë përcjellë Drejtorisë Juridike për të kërkuar kthimin e tyre në titull ekzekutiv, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 1,000,000 lekë, si dhe nuk janë aplikuar kamatë vonesat 2% në muaj të masës së gjobës, veprime këto në kundërshtim me nenin 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Shijak, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e 2 kundërvajtësve në vlerën **1,000,000** lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës së gjobave brenda afatit, kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përlllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Ky rekomandim nuk është realizuar

D.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Shijak për vitin 2023, u konstatua vlere 2,185,000 lekë, shpenzimeve pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet për qira objektsh të marra nga bashkia, për përdorim si magazinë të ushqimeve, materialeve të ndërtimit dhe elektrike, në vend që t'i kalonin direkt në vendet e përdorimit në kopshte e çerdhe, në rrugë për meremetimet e kryera dhe në objektet e ndriçimit, etj. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për shmangien e shpenzimeve për marrje ambientesh me qira për efekt magazinimi, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të këtij zëri shpenzimesh.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Ambientet e marra aktualisht me qira deri në këto momente janë të domosdoshme për nevojat e

bashkisë Shijak.

Rekomandimi nuk është zbatuar

E. MASA ADMINISTRATIVE.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 41 –“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 67- “Klasifikimi i ofertave”, 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- Anëtarët e Hartimit të specifikimeve teknike dhe Njësisë së Prokurimit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 –“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 78- “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas procedurave të mëposhtme:

- 1.Procedura me objekt “*Rikonstruktion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak*” me fond limit 62,041 mijë lekë;
- 2.Procedura me objekt “*Sistemimi i përroit të Gjepales (L=275ML) dhe i përroit nga pallati i Jasharëve deri në Lumin Erzen (L=90ML)*” me fond limit 26,426 mijë lekë;
- 3.Procedura me objekt “*Rikonstruktion i 7 rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak dhe Nj.Ad Gjepalaj*” me fond limit 41,832 mijë lekë;
- 4.Procedura me objekt “*F.V pompë uji për stacionin e pompës Eminas i Vogël*” me fond limit 2,160 mijë lekë;
- 5.Procedura me objekt “*Blerje pjesë këmbimi për mjetet e Bashkisë Shijak*” me fond limit 5,228 mijë lekë;

b- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 9- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92-

“Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”, sipas procedurave të mëposhtme:

1.Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak” me fitues BOE “A.” ShPK dhe “H.” ShPK me vlerë kontrate 60,167 mijë lekë;

2.Procedura me objekt “Sistemimi i përroit të Gjepales (L=275ML) dhe i përroit nga pallati i Jasharëve deri në Lumin Erzen (L=90ML)” me fitues OE “D.” ShPK me vlerë kontrate 17,051 mijë;

3.Procedura me objekt “Rikonstruksion i 7 rrugëve të brendshme në Bashkinë Shijak dhe Nj.Ad Gjepalaj” me fitues OE “A.” ShPK me vlerë kontrate 39,999 mijë lekë;

4.Procedura me objekt *Blerje pjesë këmbimi për mjetet e Bashkisë Shijak*” me fitues subjekti B. M. p.f me vlerë kontrate 4,576 mijë lekë;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 45-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Agjensia e Prokurimit me shkresën nr 5415/5 prot datë 13.3.2025 dhe protokolluar me tonën me nr 1312 prot datë 19.3.2025 ka përcjellë pranë Institucionit të Bashkisë Shijak, vendimet e mara dhe masat e gjobave për punonjësit e përfshirë në procedurat e tenderave për vitin 2023 si anëtarë të përfshirë në NJHST NJP dhe KVO.

Si më poshtë janë bërë njoftimet e punonjësve të vecanta:

Me shkresën nr 1380 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.H. K. për gjobën e vendosur në masën 50.000 lekë.

Me shkresën nr 1381 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.A. C. për gjobën e vendosur në masën 50.000 lekë.

Me shkresën nr 1382 prot datë 21.03.2025 është njoftuar znj.A. M. për gjobën e vendosur në masën 80.000 lekë.

Me shkresën nr 1383 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.J. G. për gjobën e vendosur në masën 70.000 lekë.

Me shkresën nr 1384 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.Gj. C. për gjobën e vendosur në masën 70.000 lekë.

Me shkresën nr 1386 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.T. P. për gjobën e vendosur në masën 50.000 lekë .

Me shkresën nr 1388 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.Sh. D. për gjobën e vendosur në masën 60.000 lekë.

Me shkresën nr 1389 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.N.K. për gjobën e vendosur në masën 70.000 lekë.

Me shkresën nr 1390 prot datë 21.03.2025 është njoftuar z.Xh. K. për gjobën e vendosur në masën 60.000 lekë.

Punonjësit e kanë ankimuar në Gjykatën Administrative Tiranë.

Rekomandimi është zbatuar

F. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë

procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

c. “Vërejtje”, për punonjësit si më poshtë:

1. Zj. J. G., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Shijak, nga periudha 01.01.2023, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F”, Xh, Shijak.

2. *“Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak.

3. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. *“Kapanon industrial frigoriferik”*, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

5. *“Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”*, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B T A” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. Z. B. T., me detyrë specialist në DPKZHT, nga periudha 02.11.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **4 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “Fillaka”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak

3. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. *“Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”*, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

3. Z. R. Sh., me detyrë specialist në DPKZHT, nga periudha 18.07.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M M ”ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. Zj.T. P., me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 13.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak

3. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. *“Kapanon industrial frigoriferik”*, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

5. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Për punonjësit e sipërcituar nuk janë marrë masa vërejtje për shkak se janë punonjës të përfshirë në procedurat e prokurimeve për të cilët është propozuar ndër të tjera dhe marrja e masave administrative në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Rekomandimi nuk është zbatuar

F.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore” dhe kontratës individuale, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse **“Vërejtje” për 7 punonjës**, si më poshtë:

1. Z. E. K., Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit, zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe mos ndjekja e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e gjobave;

Për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara dhe pajisjen me certifikatë përdorimi me objekt:

1. “Kapanon industrial frigoriferik”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. Z. J. K., me detyrë inspektor i IMT-së, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara dhe pajisjen me certifikatë përdorimi me objekt:

1. “Kapanon industrial frigoriferik”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

3. Z. E. R., me detyrë inspektor i IMT-së, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara dhe pajisjen me certifikatë përdorimi me objekt:

1. “Kapanon industrial frigoriferik”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

4. Z. E. V., me detyrë inspektor i IMT-së, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara dhe pajisjen me certifikatë përdorimi me objekt:

1. “Kapanon industrial frigoriferik”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. “Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

5. Zj. E. L., supervizore e pastrimit,

6. Zj. D. E., supervizore e pastrimit,

7. Zj. H. Xh., supervizoren e varrezave,

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

- Për mungesë të mbikëqyrjes së pastrimit të qytetit në mënyrë periodike dhe mungesë të dokumentimit të punës së tyre, konkretisht:

- mungojnë procesverbalet ditore, për cilësinë e shërbimeve, për punën e kryer dhe të pakryer për çdo zë pune sipas zonave dhe rrugëve me nënshkrimet e përfaqësuesit të kompanisë sipërmarrëse, në kundërshtim me pikën 18.4/5/i dhe pikën 18.4/6/e të rregullores së brendshme të bashkisë, miratuar në këshillin bashkiak.

- mungon informacioni i plotë mujor dhe nuk bashkëngjitet me situacionin mujor.

- nuk pasqyrohen zbritjet për ditët me shi në zërat e fshirjes së rrugëve, shesheve, freskimit të tyre, pasi ato janë pasqyruar të plota në situacion me nga 30 dhe 31 ditë/muaj.

- nuk kanë aplikuar penalitetet ndaj firmës së pastrimit për punë të pakryera të konstatuara.

- nuk disponohet asnjë procesverbal ditor dhe informacion mujor për mirëmbajtjen e varrezave.

- nuk kanë pasqyruar dhe zbritur sipërfaqet tjera të zëna nga rikonstruksionet e rrugëve, shesheve, trotuareve të qytetit të kryera gjatë vitit 2023, konkretisht: për investimin “*rregullimin e rrugëve të brendshme Shijak*”, rezultoi vlera 35,162 lekë punë e pakryer, për firmën e pastrimit “*AMR*” ShPK.

Nga subjekti janë marrë masat si vijon:

Masat e mara nga Titullari i Insitucionit janë:

Me shkresën nr 3051 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 195 është marë masë vërejtje për inspektorin E. R.

Me shkresën nr 3052 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 196 është marë masë vërejtje për inspektorin E.V.

Me shkresën nr 3053 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 197 është marë masë vërejtje për inspektorin J. K.

Me shkresën nr 3055 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 199 është marë masë vërejtje për inspektorin H. Xh.

Me shkresën nr 3054 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 199 është marë masë vërejtje për inspektorin E. K.

Me shkresën nr 3056 prot datë 23.07. 2024 dhe nr vendimi 200 është marë masë vërejtje për inspektorin E. L.

Rekomandimi është zbatuar

F.3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

b. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

1.Z.E.V., me detyrë specialist, nga periudha 08.09.2022 deri në 09.11.2023, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1.“*Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës*”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak.

2.“*Kapanon industrial frigoriferik*”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

F.4. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Shijak, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

D.3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Shijak, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 628/4, Prot. Datë 11.09.2025 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin nr. 2.2 për mungesën në punimet e kryera nga BOE “A.” sh.p.k dhe “H.” sh.p.k, për vijëzimet me shirita gjatësor dhe anësor si dhe pajisje për mbrojtjen e ndriçuesve LED, nga shkarkimet atmosferike në vlerën 3,325,910 lekë, titullari i AK me urdhrin nr. 448, datë 01.09.2025 ka ngritur komisionin për verifikimin e punimeve.

Ky komision ka mbajtur proces-verbalin nr. 4117/1 Prot., datë 02.09.2025 duke certifikuar punimet e sa mësipërme të kërkuara për tu plotësuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket rekomandimit 4.1, institucioni ka filluar procedurat gjyqësore për Xh. T. dhe A. C. në cilësinë e investitorëve për objektin “Kapanon industrial 1 kat show room dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe rekomandimi kalon në statusin në zbatim.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me detyrimin e lënë për shoqërinë “R.” sh.p.k., subjekti ka

bërë kërkesë për ndryshimin e lejes dhe më datë 24.07.2025 me vendimin nr. 298 është miratuar leja e ndërtimit nr. 3506./1 Prot., dhe është kryer pagesa e taksës së infrastrukturës me vlerë 2,262,730 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të jetë pjesë e verifikimit në auditimin e ardhshëm.

Pretendimi i subjektit:

Për rekomandimin 5.2 faqe 80, Në lidhje me *“Për kryerjen e ndryshimeve në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.”*

-Rregullorja e brendshme është e përditësuar me ndryshimet në strukturë .

Sa i përket paragrafit në pikën 5.2 faqe 80 *" Hartimi i dokumentit "Harta e proceseve te punës Hartimin dhe zbatimin e programit te trajnimit te stafit te bashkisë, me qellim zhvillimin profesional te tyre.”*, sqarojmë se trajnimi i punonjësve është kryer në bazë të planit të trajnimit të tyre. Ky plan është bërë në bazë të nevojave për trajnim të sjellë me kërkesë nga drejtuesit e sektorëve përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe do të jetë pjesë e verifikimit në auditimin e ardhshëm.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të periudhës 2024 të Bashkisë Shijak, u konstatua se planifikimet fillestare të buxhetit për shpenzime dhe investime nuk janë realizuar, kryesisht për mosrealizim të të ardhurave.

-Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak shpenzimet janë realizuar në masën 71%, ku nga vlera e planifikuar prej 759,159,000 lekë, është realizuar vlera 220,843,000 lekë, nga të cilat:

Shpenzime për investime në vlerën 114,530,000 lekë; shpenzime operative në vlerën 86,641,000 lekë; shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 19,672,000 lekë.

-Për vitin 2024, nga Bashkia Shijak të ardhurat janë realizuar në masën 75%, ku nga vlera e planifikuar prej 282,581,000 lekë, është realizuar vlera 211,587,000 lekë.

Nga Bashkia Shijak nuk është kryer një analizë e detajuar për arsyet e mosrealizimit të zërave të buxhetit 2024, realizimin në masën 75 % të të ardhurave duke kushtëzuar dhe shpenzimet, një situatë kjo e cila përsëritet ndër vite.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 32, *“Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”*, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; pikat 6, 97, 101 dhe 103 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar; nenet 34, 36 dhe 38, të Ligjit nr. 68/2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”* i ndryshuar; si dhe pikën 8, Kreu 1, në Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2018 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*, i ndryshuar dhe VKB të bashkisë Shijak, nr. 51 datë 30.11.2023, *“Për paketën fiskale 2024”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-52 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, të marrin masa për hartimin buxhetit vjetor mbështetur në realizimet e mëparshme dhe mundësitë objektive të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar me analiza periodike të veprimtarisë për realizimin e zërave përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan anomali në hartimin e pasqyrave financiare në llogaritë si vijon: -Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*”, dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 2 (dy) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata jo materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 804,209 lekë dhe shpenzime amortizimi në vlerën negative 120,632 lekë. Në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe zërave të amortizimit përkatës janë të regjistruara 3 (tre) zëra që përshkruajnë aktive afatgjata materiale me kosto historike dhe vlerë kontabël negative 5,844,693 lekë dhe shpenzime amortizimi me vlerë kontabël negative 292,234 lekë, regjistrime në kundërshtim me pikat nr. 2.1, 5,6, 29 dhe 30 të Udhëzimit nr. 8, “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-52 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shijak, të marrë masa për klasifikimin e saktë të aktiveve, sistemimin e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i llogarive së shpenzimeve, 6001 “*Paga, personel i përhershëm*”, 6010, “*kontribute sigurime shoqërore*”, 6011 “*kontribute sigurime shëndetësore*” si dhe deklaratimet në sistemin tatimor për pagat bruto dhe detyrimet tatimore, për periudhën dhjetor 2023 deri në nëntor 2024, u konstatua një diferencë në vlerën 3,206,913 lekë në zërin shpenzime paga dhe 1,250,516 lekë në zërin shpenzime për kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore.

Kjo diferencë mes shpenzimeve për paga e deklaruar në pasqyrat financiare dhe atyre të deklaruara në tatime, është pjesa e pagave dhe kontributeve të paguara nga Projekti i Bashkimit European me nr. Kontrate IPA/2022/433-142 dhe nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) sipas marrëveshjes nr. 323/2 datë 29.03.2024.

-Nga Bashkia Shijak mbulimi i shpenzimeve të pagave kryer nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), sipas marrëveshjes nr. 323/3 prot. datë 29.03.2024, nuk është pasqyruar në grandet e përfituara. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, punëdhënësit i disbursohet 20% e grandit sipas pikës 4 te kreut IV “*Mbështetja e përfituesve*” të VKM Nr. 535, datë 08.07.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e punëve publike në komunitet.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën nr. 47/a të Udhëzimit nr. 8, “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-52 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shijak, të marrë masa për regjistrimin e saktë të kostove të shpenzimeve për detyrimet për tatime e sigurime shoqërore e shëndetësore si dhe sistemit përkatëse në të ardhurat nga grantet, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit përdorin program “*Excel*” për regjistrimet e veprimeve kontabël si dhe për mbajtjen e regjistrit të aseteve të njësisë vendore. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri, pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, mund të ndikojnë në pasaktësi të veprimeve e rrjedhimisht në rezultate jo të sakta. Kjo gjë rrit riskun e mos regjistrimeve kontabël në mënyrë të drejtë dhe të saktë, si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe

sistemimin e anomalive\\$. Mungesa e një programi të specializuar për menaxhimin e të dhënave, përveç gabimit njerëzor, mbart riskun e humbjes së të dhënave të rëndësishme për shkak të mungesës së backup-it automatik, veprime këto në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, germa “dh”; neni 29, pika 1; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1; me pikat nr. 14 e 15, të nenit 3, si dhe neni nr. 11, i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; me pikat nr. 26-30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-28 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik për një menaxhim të sigurt dhe efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë, të marrin masa për kalimin në sisteme të avancuara dhe të integruara informatike, të cilët do të rrisin efikasitetin në menaxhim dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

-Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2024 mbi rregulloren e brendshme.

-Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2024, ka mangësi për pozicionet kryesore drejtuese si dhe ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës, në numrin e saj.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me ndryshimet e strukturës.

- Nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).

- Nuk janë hartuar “Hartat e proceseve të punës”.

-Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se nuk është miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e tij.

-Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i strategjisë së menaxhimit të riskut.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatori të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Në Bashkinë Shijak nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të licencuara.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatori të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më

hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-28 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

5.2. Rekomandimi: Drejtori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për:-Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Shijak përgjatë vitit 2024, u konstatua se:

-Nuk është realizuar plani i auditimeve, nga 9 auditime të planifikuara janë realizuar 2 prej tyre si dhe nuk janë analizuar shkaqet e mos kryerjes.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-28 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shijak, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lartë si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj., në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

Përgjatë vitit 2026 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, konstatohet se sipas akt-rakordimeve midis Bashkisë Shijak dhe degës së thesarit Durrës për vitin 2024, Drejtorja e financës ka të dokumentuara ngurtësimet gjatë vitit 2024 në vlerën 39,584,878 lekë për 20 subjekte. Gjatë vitit 2024 shtesat janë në vlerën 6,764,102 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 11,408,883 lekë për 10 subjekte. Për 13 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 1,997,454 lekë, sipas aneksit nr.11, pika 2, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Mos marrja e veprimeve për likuidimin ose mbajtjen e vlerave të ngurtësuara pas kalimit të afateve të garancisë ka si pasojë mos përdorimin për interes publik të këtyre fondeve.

Veprimet e mosveprimeve janë në mos respektim të kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në

Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-52 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: -Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shijak, të marrin masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, për përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me inventarizimin e aktiveve në fund të vitit, u konstatua që Bashkia Shijak nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve në përputhje udhëzimin përkatës.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të inventarizimit për periudhën 2024 u konstatua se fletët e listave të zërave të aktiveve, nuk kanë përshkrime të sakta dhe identifikuese të aktiveve pjesë e procesit të inventarizimit duke mos dhënë siguri për materialet e tjera. Komisionet e inventarizimit të aktiveve nuk kanë përpiluar raportin përkatës për t’ja dorëzuar Nëpunësit Autorizues.

-Në lidhje me aktivet u konstatua se nga institucioni nuk është kryer procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuar për dalje nga përdorimi për periudhën 2024. Bazuar në të dhënat kontabël janë gjendje aktive të cilat kanë mbaruar ciklin e përdorimit, nuk janë më në gjendje pune ose në përdorim. Për këto aktive nga institucioni nuk është iniciuar procesi i vlerësimit të tyre për të gjykuar për kosto-përfitimin dhe zëvendësimin e tyre.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pikat 5 e 95 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-52 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shijak të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për të kryer procesin e inventarizimit të aktiveve të bashkisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në fund të vitit 2025

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shijak, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivitetit, shënimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e daljes në përdorim duke e bërë të vështirë përlllogaritjen e vlerës së mbetur.

Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vijimësinë e saj.

Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve rrit riskun për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 28-52, të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Bashkia Shijak të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të aktiveve dhe mirë menaxhimin e tyre.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga KLSH, me shkresën me nr. 357/8 prot., datë 15.07.2024, rezultoi se:

-Titullari i bashkisë Shijak me shkresën nr.3005 Prot., datë 19.07.2024, ka urdhëruar përgatitjen e programeve për zbatimin e rekomandimeve me afate dhe personat përgjegjës për ndjekjen si dhe ka dërguar në KLSH për njohje, planin e masave me shkresën nr. 3158 prot., datë 30.07.2024 brenda afatit 20 ditor.

-Në lidhje me respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ky afat nuk është zbatuar nga Bashkia Shijak, pasi raportimi është kryer më datë 07.05.2025, rreth 4 muaj më vonë.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 1 është zbatuar, 12 janë në proces zbatimi, dhe 3 nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 8 rekomandime, të cilat 3 janë në proces zbatimi, 3 janë zbatuar dhe 2 nuk janë zbatuar.

-Për uljen e borxhit tatimor janë lënë 2 rekomandime të cilat nuk janë zbatuar.

-Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara është lënë 1 masë e cila nuk është zbatuar.

-Për masa disiplinore janë lënë 14 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 10 dhe janë lënë pa zbatuar 4.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 52-76 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim : Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pazbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria e Financës të marrë masa:

- Për verifikimin me specialistë të fushës të gjendjes së 3 autoveturave jo funksionale, mbi bazën e të cilit të vendoset për rregullimin ose nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre, sipas procedurave ligjore.

- Për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve për rindërtimin e shtëpive nga pasojat e tërmetit të datës 26.11. 2019.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për kontabilizimin e Aseteve të Bashkisë Shijak për vitin 2023 dhe regjistrimin e tyre në ASHK, rezultoi:

-115 prona të paluajtshme shtetërore nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, në kundërshtim me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësit vendore” neni 18, me ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifa e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pikat 20, 21, 22.

-54 prona të transferuara nuk janë regjistruar në kontabilitet, të cilat paraqiten në sipërfaqe dhe jo në vlerë, përkatësisht: varrezat, lapidarët, repartet ushtarakë, qendra shëndetësore, poliklinika, kabina elektrike, posta e re dhe e vjetër, lulishte, fushë grumbullimi e mbeturinave, truall mbi

tokat bujqësore, etj, veprime ne kundërshtim me ligjin 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin pronave paluajtshme publike Njësitë Qeverisjes Vendore”, me VKM 500 datë 14.8.2001 “Për inventarizimin PP Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë Vendore”.

Theksojmë se 61 prona janë të regjistruara në kontabilitet, si rezultat i pronave të transferuara me VKM nr. 44 datë 01.01.2011 dhe me VKM nr. 896 datë 21.12.2011.

-Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar nuk është regjistruar në ASHK. Sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, ndryshuar me VKM 684 date 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje e kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish-komunave/Bashkive”, i janë kaluar në pronësi Bashkisë Shijak me sipërfaqe gjithsej 427,2 ha, nga këto: Pyje 380,69 ha, Kullotë 16,35 ha, Toka joproductive 30,16 ha (tokë me bimësi pyjore) dhe Shkëmbore dhe ujore s’ka ha etj.

Nuk ka plan menaxhimi të ekonomisë pyjore të miratuar, por është planifikuar për vitin 2024.

Administrata e bashkisë i ka regjistruar në kontabilitet këto pasuri pyje e kullota.

Pronat në pronësi/përdorim të certifikuara ose jo nuk ka të lëshuar me kontratë qiraje.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria Juridike që mbulon Asetet, të marre masa: -Për pajisjen me certifikatë pronësie të 115 pronave të paluajtshme shtetërore të bashkisë, duke aplikuar pranë ASHK Durrës.

2.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë ma sa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shijak Sh.a., për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

4.2 Rekomandimi: Bashkia Shijak, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t’i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Durrës vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

-Për shpërblimin e dëmit 2 rekomandime nuk janë zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim, Kontroll Zhvillim Territorit Bashkia Shijak, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës prej 11,286,186 lekë, nga mos llogaritja e saktë e TNI, respektivisht për subjektet:

- vlera 8,185,250 lekë nga zhvilluesi “R.” ShPK;

- vlera 3,100,936 lekë nga zhvilluesi Xh. T. dhe A. C.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Shijak, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 722,000 lekë, konkretisht:

-Vlerën 722,000 lekë nga subjekti “K. K.” ShPK.

-Për uljen e borxhit tatimor janë lënë 2 rekomandime të cilat nuk janë zbatuar.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, me qëllim arkëtimin dhe sistemimin e debitorëve të taksave vendore për vlerën 129,474,262 lekë, përkatësisht:

-vlerën 110,360,791 lekë debitor të taksës tokës bujqësore, debitor të biznesit të madh dhe biznesit të vogël të bashkisë dhe 3 njësi administrative Shijak

-vlerën 2,113,471 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për 30 subjekte.

-vlera 17,000,000 lekë debitor për tregtimin e karburanteve pa licencë për 17 subjekte.

2.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Shijak, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e 2 kundërvajtësve në vlerën 1,000,000 lekë, duke

ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës së gjobave brenda afatit, kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

-Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara është lënë 1 masë e cila nuk është zbatuar.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për shmangien e shpenzimeve për marrje ambientesh me qira për efekt magazinimi, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të këtij zëri shpenzimesh.

-Për masa disiplinore janë lënë pa zbatuar 4.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

c. “Vërejtje”, për punonjësit si më poshtë:

1. Zj. J. G., me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Shijak, nga periudha 01.01.2023, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “Fllaka”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak.

3. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. *“Kapanon industrial frigoriferik”*, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

5. *“Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”*, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

2. Z. B. T., me detyrë specialist në DPKZHT, nga periudha 02.11.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **4 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak

3. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. *“Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat”*, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

3. Z. R. Sh., me detyrë specialist në DPKZHT, nga periudha 18.07.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **2 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar me objekt:

1. *“Godinë industriale 3 kate + mure rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “F”, Xhafzotaj, Shijak.

2. *“3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues”*, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. Zj. T. P., me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 13.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të

miratuar me objekt:

1. “*Godinë industriale 3 kate + mure rrethues*”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues “R.” ShPK, në adresën rruga “Fllaka”, Xhafzotaj, Shijak.

2. “*Kapanon industrial 1 kat + shoëroom dhe zyra 3 kat dhe rrethim i pronës*”, miratuar me vendimin Nr. 193, datë 04.05.2023, me zhvillues Xh. T. dhe A. C., në adresën fshati Vlashaj, Rr. Maminas-Sukth, Shijak

3. “*3 Godina industriale 1 dhe 2 kate + mur rrethues*”, miratuar me vendimin Nr. 4201/1 Prot., datë 15.09.2023, me zhvillues “M. M.” ShPK, në adresën rruga Xhafzotaj, Shijak.

4. “*Kapanon industrial frigoriferik*”, miratuar me vendimin Nr. 157 Prot., datë 14.04.2023, me zhvillues “C.” ShPK, në adresën Sallmone, Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

5. “*Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat + zyra 2 kat*”, miratuar me vendimin Nr.370 Prot., datë 06.10.2023, me zhvillues “B. T. A.” ShPK, në adresën Njësia Administrative Xhafzotaj, Shijak.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT